

## **I. HYRJE NË SISTEMIN E TË DREJTAVE TË NJERIUT**

DINJITETI NJERËZOR

TË DREJTAT E NJERIUT

ARSIMIMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT

SIGURIA NJERËZORE

---

*>> Kultura e të drejtave të njeriut nxjerr fuqinë e saj më të madhe nga parashikimet e paraqitura të çdo individi. Përgjegjësia për mbrojtjen e të drejtave të njeriut bie mbi shtetet. Mirëpo, ato që u japin të drejtave të njeriut strukturën e tyre ditore dhe qëndrueshmërinë e tyre të vazhdueshme janë, të kuptuarit, respektimi dhe parashikimet e çdo personi individual për të drejtat e njeriut.<<*

**SERGIO VIEIRA DE MELLO, KOMESAR I LARTË I KOMBEVE TË BASHKUARA PËR TË DREJTAT E NJERIUT, 2003**



### **A. KUPTIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT**

Aspirata për të mbrojtur dinjitetin njerëzor të të gjitha qenieve njerëzore, paraqet thelbin e konceptit për të drejtat e njeriut. Kjo aspiratë e vë qenien njerëzore në qendër të interesit. Kjo aspiratë është e bazuar në sistemin e përbashkët universal të vlerave të përkushtuara të të drejtës për jetë, si një e drejtë e paprekshme, dhe ofron një kornizë për ndërtimin e sistemit të të drejtave të njeriut, të mbrojtur nga normat dhe standardet e pranuar ndërkombëtarisht. Gjatë shekullit XX, të drejtat e njeriut janë zhvilluar si formulime morale, politike dhe ligjore dhe udhërrëfyese për zhvillimin e një bote të lirë nga frika dhe skamja.

Neni 1 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (UDHR), të miratuar nga Kombeve të Bashkuara në vitin 1948, u referohet shtyllave kryesore të sistemit të të drejtave të njeriut, të cilat janë liria, barazia dhe solidariteti. Liritë, siç janë liria e mendimit, ndërgjegjes, besimit, sikurse edhe ajo e opinionit dhe shprehjes, janë të mbrojtura nga të drejtat e njeriut. Ngjashëm, të drejtat e njeriut garantojnë barazi, siç është mbrojtja e barabartë kundër të gjitha formave të diskriminimit për të gëzuar të gjitha të drejtat e njeriut, duke përfshirë edhe barazinë e plotë ndërmjet grave dhe

burrave. Solidariteti tregon të drejtat ekonomike dhe sociale, si të drejtën për sigurim social, shpërblim (pagë) të drejtë, një standard të mirë për jetesë, shëndet dhe qasje në arsim, të cilat janë pjesë përbërëse të strukturës së të drejtave të njeriut. Këto të drejta janë të sistemuara në pesë kapituj; të drejtat politike, civile, ekonomike, sociale dhe kulturore dhe janë të definuara juridikisht në dy Pakte paralele, të cilat së bashku me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, krijojnë Ligjin mbi të Drejtat e Njeriut.

*>> Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në pikëpamje të dinjitetit dhe të të drejtave. Ata ... duhet të sillen ndaj njëri-tjetrit në frymën vëllazërore.<<*

### **NENI 1 I DEKLARATËS UNIVERSALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT.**

“Të gjitha të drejtat e njeriut për të gjithë” ishte parulla e Konferencës Botërore për të Drejtat e Njeriut në Vjenë, të vitit 1993. Të drejtat e njeriut, janë ato që u japin fuqi individëve dhe bashkësive të kërkojnë transformimin e plotë të shoqërisë në drejtim të realizimit të plotë të të gjitha të drejtave të njeriut. Konfliktet duhet të zgjidhen me mjete paqësore, duke u bazuar në sundimin e ligjit dhe në strukturën e të drejtave të njeriut. Sidoqoftë, të drejtat e njeriut mund të ngatërrohen mes vete; ato kufizohen nga të drejtat dhe liritë e të tjerëve ose nga kërkesat morale, publike, ose të rendit publik dhe mirëqenies së përgjithshme të një shoqërie demokratike (Neni 29 i UDHR). Të drejtat e të tjerëve, jo vetëm që duhet të tolerohen, por edhe duhet të respektohen. Të drejtat e njeriut nuk mund të përdoren për shkeljen e të drejtave njerëzore të të tjerëve (Neni 30 UDHR); kështu që, edhe pse në disa situata të jashtëzakonshme dhe raste ekstreme, mund të vihen disa kufizime, të gjitha konfliktet duhet të zgjidhen në frymën e të drejtave të njeriut.

*>>Asnjë shprehje e kohës së fundit të historisë njerëzore nuk ka qenë më e privilegjuar për të bartur misionin dhe barrën e së ardhmes njerëzore sesa [shprehja] >të drejtat e njeriut<. . . – nocioni i të drejtave të njeriut është dhuntia më e mirë e mendimit njerëzor klasik dhe bashkëkohor. Në të vërtetë, në këtë kohë të historisë, gjuha e të drejtave të njeriut, (është) në disponim tonë më shumë se çfarëdo gjuhe tjetër morale. . .<<*

**NGA “PADREJTËSITË ÇNJERËZORE DHE TË DREJTAT E NJERIUT” – PROF. UPENDRA BAXI**

Prandaj, çdokush - gratë, burrat, të rinjtë dhe fëmijët duhet t'i dinjë dhe kuptojnë të drejtat e tyre njerëzore, që janë të rëndësishme për interesat dhe qëllimet e tyre. Kjo mund të arrihet përmes arsimimit dhe mësimi për të drejtat e njeriut, arsimim ky që mund të jetë zyrtar, jozyrtar ose joformal. Kuptimi i parimeve dhe procedurave të të drejtave të njeriut, ua mundëson njerëzve të marrin pjesë në vendimet që përcaktojnë jetën e tyre, të punojnë drejt zgjidhjes së konflikteve dhe ruajtjes së paqes të bazuar në të drejtat e njeriut, e cila është një strategji frytdhënëse e bazuar në interesat e popullit për zhvillim njerëzor, social dhe ekonomik.

Arsimimin për të drejta të njeriut duhet ta bëjnë të gjitha palët ose pjesëmarrësit, shoqëria civile, sikurse edhe qeveritë dhe kompanitë transnacionale. Përmes njohurive për të drejtat e njeriut, mund të zhvillohet vërtet një “kulturë mbi të drejtat e njeriut”, e bazuar në respektimin, mbrojtjen, përmbushjen, zbatimin dhe praktikimin e të drejtave të njeriut. E drejta për arsimim për të drejtat e njeriut mund të nxirret nga Neni 26 i UDHR-së, sipas të cilit “çdokush ka të drejtën për arsimim . . . . Arsimimi duhet të orientohet drejt zhvillimit të plotë të personalitetit të njeriut dhe forcimit të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut . . .”.

>> *Arsimimi, mësimi dhe dialogu për të drejtat e njeriut duhet të nxisin brenda strukturës së të drejtave të njeriut mendim kritik dhe analizë sistematike me perspektivë në interesat politike, civile, ekonomike, sociale dhe kulturore.* <<

**SHULAMITH KOENIG, PDHRE (LËVIZJA POPULLORE PËR ARSIMIM PËR TË DREJTAT E NJERIUT)**

>> *Arsimimi për të drejtat e njeriut nënkupton tërësinë e mësimi që zhvillon njohuri, aftësi dhe vlera për të drejtat e njeriut, i cili përkrah paanshmërinë, tolerancën, dinjitetin dhe respektin për të drejtat dhe dinjitetin e të tjerëve.* <<

**NANCY FLOWERS, QENDRA PËR TË DREJTAT E NJERIUT E UNIVERSITETIT TË MINESOTËS.**

Resoluta 49/184, e 23 dhjetorit 1994, e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, duke proklamuar Dekadën e OKB-së për Arsimim për të Drejtat e Njeriut, flet për procesin e mësimi të përhershëm dhe gjithëpërfshirës, ndërsa Plani Veprues i

Dekadës së OKB-së për Arsimim në fushë të të Drejtave të Njeriut 1995-2004, jep definicionin e detajuar për Arsimimin për të Drejtat e Njeriut dhe elaboron përmbajtjen dhe metodikën e mësimin (UN Doc. A/51/506, Add. 1 of 12 December 1996).



**Rezoluta 49/184 e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së**, e 23 dhjetorit 1994, duke shpallur Dekadën e OKB-së për HRE (Arsimim për të Drejtat e Njeriut ) thekson: *“shkollimi mbi të drejtat e njeriut duhet të përfshijë më tepër se vetëm pjesën informative dhe duhet të jetë proces i përhershëm dhe gjithëpërfshirës në të cilin njerëzit e të gjitha niveleve të zhvillimit dhe shtresave të shoqërisë mësojnë për respektin ndaj dinjitetit të të tjerëve, si dhe për mjetet dhe metodat e sigurimit të atij respekti në të gjitha shoqëritë.”*

Plani Veprues i Dekadës së Kombeve të Bashkuara për Arsimim mbi të Drejtat e Njeriut (1995-2004), thekson: . . . shkollimi për të drejtat e njeriut duhet definuar si trajnim, shpërndarje dhe përpjekje për informim, përmes transmetimit të diturisë dhe aftësive, me qëllim të ndërtimit të kulturës universale për të drejtat e njeriut, si dhe krijimit të sjelljeve në drejtim të:

- (a) Forcimit të respektimit për të drejtat dhe liritë fundamentale të njeriut;
- (b) Zhvillimit të plotë të personalitetit të njeriut dhe kuptimit të dinjitetit të tij;
- (c) Proklamimit të kuptimit, tolerancës, barazisë gjinore, miqësisë mes gjitha kombeve, popujve vendës dhe grupeve racore, kombëtare, etnike, fetare dhe gjuhësore;

Në deklaratën e Dekadës së OKB-së për Arsimim për të Drejtat e Njeriut (1995-2004), të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, thuhet se duhet kërkuar: *“edhe kuptimet më të gjera të të gjitha normave, koncepteve dhe vlerave të mbrojtura nga Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut”*. Shtytësi kryesor pas kësaj iniciative ka qenë Shulamith Konig (Shulamith Koenig), themeluesja e Dekadës Popullore për Arsimim për të Drejtat e Njeriut (PDHRE), e cila ka për qëllim hiç më pak sesa vizionin afatgjatë për mundësinë që çdo individ i planetit tonë të ketë qasje në të drejtat e njeriut, *“që njerëzit t'i dinjë dhe t'i kërkojnë ato”*. Prandaj, qëllimi i arsimimit për të drejtat e

njeriut është “*shkollim i të gjithëve për të drejtat e njeriut*”. Ose, sipas fjalëve të Nelson Mandelës: të “*ndërtohet një kulturë e re politike e bazuar në të drejtat e njeriut*”.

Për metodat e arsimit për të drejtat e njeriut 🧐 Vërejtjet e Përgjithshme për Metodologjinë e Arsimit për të Drejtat e Njeriut.



## **B. TË DREJTAT E NJERIUT DHE SIGURIA NJERËZORE**

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, është hartuar si rezultat i shkeljeve më serioze të dinjitetit njerëzor, e veçanërisht pas përvojës së Holokaustit gjatë Luftës së Dytë Botërore. Përqendrimi kryesor i saj është qenia njerëzore, kurse preambula e saj i referohet “*lirisë nga frika dhe skamja*”. Një qasje e ngjashme është e pranishme edhe te koncepti i sigurisë njerëzore.

>>*Shumica e kërcënimeve kundër sigurisë njerëzore nxjerrin në pah drejtpërdrejt ose tërthorzi dimensionin e të drejtave të njeriut.*<<

**TAKIMI I DYTË MINISTROR I RRJETIT PËR SIGURI NJERËZORE NË LUCERN, MAJ 2000.**

Gjatë Takimit Punues Ndërkombëtar për Siguri Njerëzore dhe Arsimim mbi të Drejtat e Njeriut, në korrik të vitit 2000 në Grac, është theksuar se siguria njerëzore ka për qëllim që përmes parandalimit të konflikteve dhe adresimit të hollësishëm të shkaqeve të pasigurisë dhe nënshtrimit t’i mbrojë të drejtat e njeriut. Strategjia e sigurisë njerëzore ka për qëllim krijimin e kulturës politike globale të bazuar në të drejtat e njeriut. Në këtë kontekst, arsimimi për të drejtat e njeriut paraqet një strategji në drejtim të realizimit të sigurisë njerëzore, pasi që i mëson njerëzit që zgjidhjet e problemeve të tyre t’i kërkojnë para së gjithash në bazat e sistemit të vlerave të përgjithshme globale, të mbështetura në sundimin e ligjit dhe në të drejtën, e jo duke u bazuar në pushtet. Siguria njerëzore promovohet nëpër shoqëri në formë të decentralizuar, duke filluar nga nevojat themelore të njerëzve, si ato të grave ashtu edhe të burrave, që do të thotë se fillohet nga problemet e sigurisë personale, varfërisë, diskriminimit, drejtësisë sociale dhe demokracisë. Liria nga eksploatimi ose korrupsioni fillon vetëm atëherë kur njerëzit nuk pranojnë, që të drejtat e tyre të shken edhe më tutje. Institucionet e shoqërisë civile (sikuse

*Transparenca Ndërkombëtare*), përkrahin procesin e tillë të emancipimit, të bazuar në njohuritë mbi të drejtat e njeriut.

>> *Të drejtat e njeriut ofrojnë bazën e nevojshme mbi të cilën do të vazhdohej zhvillimi njerëzor dhe siguria njerëzore.* <<

### **TAKIMI I KATËRT MINISTROR I RRJETIT TË SIGURISË NJERËZORE NË SANTIGO DE CHILE, KORRIK 2002.**

Ekzistojnë disa **lidhje ndërmjet të drejtave të njeriut dhe sigurisë njerëzore**. “*Siguria*” në formë të sigurisë personale (si p.sh. mbrojtja nga arrestimi arbitrar), sigurisë sociale (si p.sh. sigurimi i nevojave themelore sikurse ushqimi) dhe sigurisë ndërkombëtare (sikurse e drejta për të jetuar në një rend ndërkombëtar të sigurt), përputhet me të drejtat ekzistuese të njeriut. “*Politikat e sigursë duhet të integrohen më shumë me strategjitë për promovimin e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe zhvillimit. Të drejtat e njeriut, e drejta humanitare dhe e drejta e refugjatëve ofrojnë kornizën normative mbi të cilën bazohet qasja e sigurisë njerëzore.*” (Siguria Njerëzore: Siguria e Njerëzve në Botën e Ndryshueshme, Departamenti i Marrëdhënieve të Jashtme dhe Tregtisë Ndërkombëtare, Kanada 1999).

Cenimet e të drejtave të njeriut paraqesin kërcënime për sigurinë njerëzore, prandaj përdoren si indikatorë në kuadër të mekanizmave për paralajmërim të hershëm, me qëllim të parandalimit të konflikteve. Sidoqoftë, të drejtat e njeriut gjithashtu luanë rol gjatë periudhës së pasluftës, për menaxhimin dhe transformimin e konflikteve, si dhe për ndërtimin e paqes. Përmes transferit të dijes, ndërtimit të aftësive dhe formësimit të sjelljeve, arsimimi në fushën e të drejtave të njeriut përbën bazën e kulturës së vërtetë të parandalimit.

Përveç që të drejtat e njeriut janë një instrument esencial për parandalimin e konfliktit, ato janë gjithashtu bërthamë e konceptit të ndërtimit të qeverisjes dhe demokracisë. Gjithashtu, ato ofrojnë bazë që përmes pjesëmarrjes aktive, ngritjes së transparencës dhe ngritjes së përgjegjësisë, të bëjnë trajtimin e problemeve shoqërore dhe globale. “*Ndërtimi i qeverisjes*” përbëhet nga dy forma komplementare të ndërtimit të kapacitetve: “*ndërtimit të shtetit*” dhe “*ndërtimit të shoqërisë*”. Ndërtimi i shtetit ofron “*siguri*

*demokratike*”, që më së miri mund të shihet pas përfundimit të konfliktit në përpjekjet për rehabilitim dhe rindërtim. “*Zhvillimi shoqëror përfshin arsimimin e gjerë për të drejtat e njeriut, me qëllim të aftësisë të njerëzve për kërkimin e të drejtave të tyre dhe respektim të të drejtave të të tjerëve*” (Walther Lichem, Ministria Federale e Austrisë për Marrëdhënie të Jashtme).

*>>(Siguria Njerëzore) në esencë është një përpjekje për ndërtimin e shoqërisë globale, ku siguria e individit është në qendër të prioritetëve ndërkombëtare ...; ku standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe sundimi i ligjit janë avancuar dhe janë ndërtuar në një rrjet koherent për mbrojtjen e individit . . .<<*

### **LLOYD AXWORTHY, ISH MINISTËR I PUNËVE TË JASHTME TË KANADASË**

Komisioni për Siguri Njerëzore, i themeluar në vitin 2001, nën bashkudhëheqjen e Sadako Ogata-s (ish- Komesare e lartë e OKB-së për Refugjatë) dhe Amartya Sen (fituese e çmimit Nobel për Ekonomi) dhe në bashkëpunim me Institutin Interamerikan për të Drejtat e Njeriut, mbajtën një takim pune në dhjetor të vitit 2001, në San Jose të Kosta Rikës, lidhur me raportet mes të Drejtave të Njeriut dhe Sigurisë Njerëzore, ku ishte elaboruar mbi temën “*Deklarata për të Drejtat e Njeriut si Komponentë e Domosdoshme e Sigurisë Njerëzore*” (<http://www.humansecurity-chs.org/doc/sanjosedec.html>). Sipas Bertrand G. Ramcharan, Ndihmës i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së dhe Zëvendës i Komesarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, normat ndërkombëtare dhe të drejtat e njeriut janë ato që e përcaktojnë kuptimin e sigurisë njerëzore.

*>>Bota asnjëherë nuk do të jetë në paqe, nëse njerëzit nuk gëzojnë sigurinë njerëzore gjatë përditshmërisë së tyre.<<*

### **RAPORTI PËR ZHVILLIM NJERËZOR, UNDP 1994**

Neni 3 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (UDHR) dhe Neni 9 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, gjithashtu, mbrojnë të drejtën e lirisë dhe sigurisë personale, të cilat në veçanti i referohen lirisë nga frika. Përveç këtyre, neni 22 i UDHR dhe neni 9 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, njohin të drejtën për sigurim social, e cila së bashku me të drejtat e tjera sociale përputhen me lirinë nga skamja. Raporti mes globalizimit dhe sigurisë njerëzore

është shqyrtuar edhe nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së Kofi Annan, në Raportin e Mileniumit të 2000-të, i cili gjithashtu, bën dallimin mes **lirisë nga frika** dhe **lirisë nga skamja**, dallim i cili kthehet prapa te katër liritë e proklamuar gjatë Luftës së Dytë Botërore në vitin 1940, nga presidenti i SHBA-ve Ruzvelt (Roosevelt), si vizion i tij për rendin e vendosur pas përfundimit të luftës. Lufta kundër varfërisë dhe ajo për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore është po aq e rëndësishme për siguri, sa edhe lufta për liri politike dhe liri fundamentale. Sidoqoftë, njëra nuk mund të veçohet nga tjetra, ato janë të varura në mënyrë të ndërsjellë dhe janë të pandashme.

Siguria njerëzore paraqet mundësinë për gëzimin e rezultateve të zhvillimit njerëzor. Në bazë të Raportit të Zhvillimit Njerëzor të UNDP-së, të vitit 2000, ashtu si të drejtat e njeriut, edhe zhvillimi njerëzor, kanë vizionet dhe qëllimet e njëjta. *Treguesit për Zhvillim Njerëzor*, i cili përdoret në raportet e UNDP-së për zhvillim njerëzor, përmbajnë disa indikatorë, siç janë, qasja në arsimim, sigurimi i ushqimit, shërbimet shëndetësore, barazia gjinore dhe participimi politik, të cilat përputhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me të drejtat e njeriut. “*Raporti mbi Zhvillimin Njerëzor*”, që është duke u elaboruar nën kryesimin e Andrew Mack-ut, është përqendruar në kërcënimet e sigurisë njerëzore. Arrihet në përfundimin se, konceptet e sigurisë njerëzore, të të drejtave të njeriut dhe zhvillimit njerëzor janë të ndërlidhura ngushtë dhe përforcohen në mënyrë reciproke.



### C. HISTORIA DHE FILOZOFIA E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Ideja për **dinjitetin njerëzor**, është po aq e vjetër sa edhe vetë historia e njerëzimit, e cila në kulturat dhe religjionet e ndryshme, shfaqet në forma të ndryshme. Për shembull, në filozofinë afrikane “*ubuntu*”, dhe te mbrojtja e të huajve në islamizëm, njeriut i akordohen vlera shumë të larta. “*Rregulla e artë*”, sipas të cilës njeriu duhet t’i trajtojë të tjerët ashtu siç dëshiron ta trajtojnë vetë atë, ekziston në të gjitha religjionet kryesore. E njëjta rregull vlen edhe lidhur me përgjegjësitë e shoqërisë për përkujdesjen ndaj të varfërve të tij dhe për nocionet fundamentale të drejtësisë sociale.

Sidoqoftë, ideja për “të drejtat e njeriut” është rezultat i mendimit filozofik të kohës moderne, e bazuar në filozofinë e racionalizmit dhe iluminizmit, pastaj liberalizmit, demokracisë, por edhe të socializmit. Edhe pse koncepti modern për të drejtat e njeriut

rrjedh kryesisht nga Evropa, do theksuar se nocionet e lirisë dhe drejtësisë sociale, të cilat janë fundamentale për të drejtat e njeriut, janë pjesë e të gjitha kulturave. Kombet e Bashkuara nën udhëheqjen e Ellenor Ruzvellit (Eleanor Roosevelt), Rene Kasë (Rene Cassain) dhe Xhozef Malikut (Joseph Malik), zhvilluan Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, në të cilën kanë punuar 80 njerëz nga Veriu dhe Jugu për të konkretizuar idetë dhe gjuhën. Në ndikimin e Lindjes dhe Jugut, të drejtat e njeriut si koncepti mbi të drejtat ekonomike, sociale, kulturore, të drejtën për vetëvendosje dhe zhvillim, si dhe lirinë nga diskriminimi racor dhe aparteidi, janë shndërruar në koncept të gjithëmbarshtëm botëror,.

>>Unë jam qenie njerëzore, sepse sytë e tu më shikojnë si të tillë . . . <<

### PROVERB AFRIKAN, MALI

Duke pasur parasysh faktin se, historikisht **shtetasit** si rezultat i përpjekjeve të tyre për liri fundamentale, ekonomike dhe të drejta sociale u bënë përfitues të të drejtave të mbrojtura me kushtetutë, të **huajt** vetëm në raste të rralla ose vetëm në bazë të ndonjë marrëveshjeje bilaterale mund të ishin bartës të të drejtave. Ata kishin nevojë për mbrojtje nga shtetet e tyre, të cilat i përfaqësonin jashtë vendit.

E drejta humanitare ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm për zhvillimin e rregullave për mbrojtjen e joshitetasve. Ajo ka synuar vendosjen e rregullave themelore për trajtimin e ushtarëve armiq, e edhe të civilëve gjatë konfliktit të armatosur. (👉 Moduli për të Drejtat e Njeriut gjatë Konfliktëve të Armatosura). Fillet e hershme dhe të vërteta të të drejtave të njeriut mund të gjenden në marrëveshjet mbi **liritë e religjionit**, si në Traktatin e Vestfalisë të vitit 1648, ndalimin e skllavërisë, si në rastin e deklaratës së Kongresit të Vjenës të vitit 1815 mbi tregtinë e skllavërve, themelimin e Shoqatës Amerikanë Kundër Skllavërisë në vitin 1833, si dhe Konventën Ndërkombëtare Kundër Skllavërisë të vitit 1926. Gjithashtu, mbrojtja e të **drejtave të minoriteteve**, ka një histori të gjatë dhe ka qenë çështje kryesore e Traktatit të Paqes të Versajës, më 1919 dhe Ligës së Kombeve, që është krijuar po atë vit (👉 Kronologjia në Pjesën III: Burimet Plotësuese).

Sido që të jetë, koncepti i **të drejtave universale të njeriut**, u bë i pranueshëm për të gjitha qeniet njerëzore vetëm pas tmerreve të Luftës së Dytë Botërore, kur nga 48 shtete u arrit marrëveshja për Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut dhe 8 shtete socialiste me Afrikën e Jugut abstenuan, dhe që atëherë, ky koncept është bërë komponentë e pandashme e sistemit të Kombeve të Bashkuara. Që nga ajo kohë numri i shteteve anëtare në OKB ka arritur në 191, ndërsa kjo deklaratë, e cila sot mund të konsiderohet si e drejtë zakonore ndërkombëtare, nuk është sfiduar asnjëherë seriozisht nga këto shtete.

Në këtë kontekst, duhet përmendur, “*Deklarata e Kajros për të Drejtat e Njeriut në Islam*” e vitit 1990, hartuar nga *Ministrat e Jashtëm të Organizatës së Konferencës Islamike*, e cila nuk është miratuar formalisht asnjëherë. Të gjitha të drejtat e theksuara në këtë Deklaratë janë në pajtim me Sheriatin Islamik.

>>“(…) *Ne i konsiderojmë këto të vërteta si të pranueshme - të gjithë njerëzit janë të barabartë; të gjithë janë pajisur nga krijuesi i tyre me disa të drejta të patjetërsueshme; në mesin e të cilave janë jeta, liria dhe e kërkimi i lumturisë. Për të siguruar këto të drejta, janë themeluar qeveritë, nga pushteti ligjor i të cilave rrjedh pajtimi i të qeverisurve . . . <<*

### **DEKLARATA AMERIKANE E PAVARËSISË, (1776)**

Debati i cili bëhet kohë pas kohe për **prioritetin e disa të drejtave dhe universalitetin kudër relativizmit**, është adresuar në dy konferenca botërore për të drejtat e njeriut - në Konferencën e Teheranit dhe në atë të Vjenës. Në Konferencën e Teheranit më 1968, është sqaruar se të gjitha të drejtat e njeriut janë të pandashme dhe të varura në mënyrë të ndërsjellë mes vete, ndërsa në Konferencën e Vjenës të vitit 1993 u arrit pajtueshmëria me koncensus që: “*Deri sa rëndësia e veçorive kombëtare, regjionale si dhe të kaluarat e ndryshme historike, kulturore dhe fetare duhet të merren parasysh, është obligim i shteteve, pa marrë parasysh sistemin e tyre politik, ekonomik dhe kulturor, që të promovojnë dhe të mbrojnë gjitha të drejtat e njeriut dhe liritë fundamentale*”. (paragrafi 5 i Deklaratës së Vjenës dhe Programit të Veprimit të vitit 1993).

>>E para është liria e fjalës dhe e shprehjes – në gjithë botën. E dyta është liria e çdo personi të adhurojë Zotin në mënyrën e vet – në gjithë botën. E treta është liria nga varfëria – e cila përkthyer në gjuhën botërore do të thotë mirëkuptim ekonomik, i cili do t'i sigurojë çdo kombi jetë paqësore dhe të shëndoshë për të gjithë pjesëtarët e tij – në gjithë botën. E katërta është liria nga frika . . . <<

**PRESIDENTI ROOSEVELT, KATËR LIRITË (1941)**

*Sot, një numër shumë i madh i subjekteve ndërkombëtare ndjekin politikën e bazuar në frikë, duke menduar se do të rrisin sigurinë. Por, siguria e vërtetë duhet bazuar në parimin tashmë të provuar- atë të të drejtave të njeriut.*

**SERGIO VIEIRA DE MELLO, KOMESAR I LARTË I KOMBEVE TË BASHKUARA PËR TË DREJTAT E NJERIUT, 2003**



#### **D. KONCEPTI DHE NATYRA E TË DREJTAVE TË NJERIUT**

Nga deklarata e miratuar në vitin 1993 gjatë Konferencës Botërore për të Drejtat e Njeriut në Vjenë, me rastin përvjetorit të 50-të të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, si dhe nga rezolutat e miratuara nga Kombet e Bashkuara në vitin 1998, mund të vërehet se koncepti i të drejtave të njeriut, sot pranohet si një koncept **universal**. Disa skeptikë që dyshojnë në universalitetin e të drejtave të njeriut, duhet që ta kujtojnë faktin se shumë shtete të cilat janë gjeografikisht të kundërta, si Kina, Libani dhe Kili, gjatë pjesës së dytë të vitit 1940, kanë qenë mes atyre shteteve që kanë ndihmuar në hartimin e konceptit të tillë. Sidoqoftë, që nga ajo kohë, shumë shtete kanë shprehur përkrahjen e tyre për Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut dhe kanë ratifikuar Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR), si dhe Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (ICESCR), të cilat bazohen në Deklaratën Universale. Në rastin e Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), me gjithë rezervat e shumta, ajo është ratifikuar nga 177 shtete.

Si pikë fillestare e konceptit të të drejtave të njeriut është koncepti mbi *dinjitetin e lindur dhe të patjetërsueshëm të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore*, koncept i cili njihet në Deklaratën Universale dhe Paktet Ndërkombëtare të viteve 1966, të cilat njëkohësisht njohën edhe idealin e qenieve të lira njerëzore për të gëzuar lirinë nga frika dhe skamja

dhe për të qenë të pajisur me të drejta të barabarta dhe të patjetërsueshme. Prandaj, të drejtat e njeriut janë universale dhe të patjetërsueshme, që do të thotë se aplikohen gjithkund dhe nuk mund t'i mohohen individit madje edhe nëse ai/ajo pajtohet për këtë. Ashtu siç ka theksuar Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Butros Butros Gali (Boutros Boutros-Ghali) në Konferencën Botërore të Vjenës për të Drejtat e Njeriut të vitin 1993, “*të drejtat e njeriut janë të drejta të lindura*”.

Gjithashtu, të drejtat e njeriut janë të pandashme dhe reciprocikisht të varura. Mund të veçohen **dimensione ose kategori** të ndryshe të të drejtave të njeriut, siç janë: **të drejtat civile dhe politike**, siç janë liria e fjalës dhe e shprehjes, **të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore**, si e drejta në sigurim social, e cila duke pasur parasysh faktin se vendos obligime financiare mbi shtetin, duhet të “*shikohen progresivisht*”. Në të kaluarën, një kategori e caktuar e shteteve ose grupshteteve siç është grupi i shteteve komuniste, kanë shprehur preferencat e tyre ndaj të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore, në dallim prej Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe shteteve anëtare të Këshilit të Evropës, të cilët kanë përkrahur pikërisht të drejtat civile dhe politike. Sidoqoftë, në vitin 1968, gjatë Konferencës Botërore për të Drejtat e Njeriut në Teheran, dhe në vitin 1993, gjatë Konferencës Botërore për të Drejtat e Njeriut në Vjenë, ky debat joproduktiv është adresuar në atë mënyë që, është vendosur se të dy këto kategori ose dimensione të të drejtave të njeriut kanë rëndësi të barabartë. Në Teheran më 1968, këto të drejta janë deklaruar si të pandashme dhe reciprocikisht të varura, pasi që gëzimi i plotë i të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore, vështirë mund të realizohet pa gëzimin e të drejtave civile e politike dhe *vice versa*.

Gjatë viteve të 1980-ta është miratuar edhe një kategori plotësuese e të drejtave të njeriut, ku bëjnë pjesë e drejta për paqe, e drejta për zhvillim dhe e drejta për mjedis. Këto të drejta ofrojnë një kornizë të domosdoshme për gëzimin e gjitha të drejtave tjera. Sidoqoftë, nuk ekziston ndonjë kushtëzim lidhur me atë se një kategori e caktuar e të drejtave të njeriut është parakusht për ekzistimin e kategorisë tjetër. Të drejtat nga kjo kategori më së miri përkshkruhen si **të drejta solidare**, sepse kërkojnë bashkëpunim ndërkombëtar dhe qëllimi i tyre është ndërtimi i solidaritetit.

Deri sa të drejtat e njeriut janë të drejta të të gjithë individëve, pa marrë parasysh se a e kanë apo jo shtetësinë e një vendi përkatës, **të drejtat e shtetasve**, siç janë p.sh. e drejta për të votuar dhe për të qenë i votuar ose e drejta për të pasur qasje në shërbimet publike të atij vendi, janë të drejta fundamentale që ekskluzivisht u garantohen shtetasve të një vendi konkret.

Gjithashtu, të drejtat e njeriut duhet të dallohen nga **të drejtat e minoriteteve**, që janë të drejta të anëtarëve të një grupi me karakteristika të veçanta etnike, fetare ose gjuhësore. Qoftë individualisht ose në grup, ata kanë të drejtë të gëzojnë kulturën e tyre, të predikojnë dhe praktikojnë besimin e tyre, dhe të përdorin gjuhën e tyre (Neni 27 i ICCPR). Lidhur me këtë, rregulla më të hollësishme gjenden në instrumentet rajonale të Evropës për të drejtat e njeriut.

Një vëmendje e posaçme u është kushtuar të drejtave të **popujve autoktonë**. Që nga viti 1982, Grupi Punues i OKB-së për Popujt autoktonë shqyrton mënyrat për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre, e në veçanti atyre të drejtave që kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre me tokat.



Tashmë, një Deklaratë për të Drejtat e Popujve Autoktonë është hartuar, por ende nuk është miratuar, deri sa Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), duke rishikuar një deklaratë të mëhershme, në vitin 1989 miratoi *Konventën Nr. 169* lidhur me “*Popujt Autoktonë dhe Popujt e Fiseve në Shtetet e Pavarura*”. Në vitin 2001, OKB-ja ka emëruar *Raportuesin Special për të drejtat e njeriut dhe liritë fundamentale të popujve autoktonë*. Në vitin 2000, duke marrë parasysh rekomandimin e Konferencës Botërore të Vjenës për të Drejtat e Njeriut të vitit 1993, është themeluar “*Forumi i Përhershëm për Çështjet Autoktone*”, si një autoritet ndihmës i Këshillit Ekonomik dhe Social (ECOSOK), i cili për herë të parë është mbledhur në vitin 2002. Gjithashtu, Komisioni Afrikan për të Drejta të Njeriut dhe të Popujve, ka themeluar një Grup Punues për popujt autoktonë.

Sot, koncepti i të drejtave të njeriut është globalisht i pranuar dhe si i tillë shërben si bazë e bashkësisë ndërkombëtare të shteteve, organizatave ndërkombëtare dhe lëvizjeve shoqërore, të cilët e konsiderojnë veten si pjesarë të shoqërisë ndërkombëtare. Siç mund

të shihet nga përpjekjet e Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, në veçanti në rastet kur kemi të bëjmë me pranimin e anëtarëve të ri, të drejtat e njeriut, mund të jenë gjithashtu, **mjete të cilat njerëzit mund t'i përdorin si instrumente për transformime shoqërore**, qoftë në nivel kombëtar, qoftë në nivel rajonal. Sidoqoftë, me qëllim që të drejtat e njeriut të marrin efektin transformues, përdorimi i tyre si instrumente për ndryshime varet nga njohuria, të kuptuarit dhe gatishmëria e vetë popujve që t'i përdorin si të tilla.

Koncepti tradicional i të drejtave të njeriut është kritikuar nga feministet me arsyetimin se, nuk reflekton në mënyrë të drejtë barazinë mes grave dhe burrave dhe për mungesën e trajtimit gjinor. Konferencat Botërore të Grave dhe hartimi i Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, kanë kontribuar, *inter alia*, për qasjen e trajtimit gjinor të **të drejtave të grave**, gjë që është reflektuar edhe në Deklaratën e OKB-së Kundër Dhunës ndaj Grave dhe në draftin e protokollit të Kartës Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe Popujve (👉👈 Moduli për të Drejtat e Grave). Është me rëndësi të theksohet se, instrumentet për të drejtat e njeriut paraqesin një koncept të ri politik dhe social, të cilat i pranojnë gratë si qenie njerëzore plotësisht të barabarta me të tjerët.

Disa shtete, duke përdorur si argumente ekzistimin e **veçorive historike, fetare dhe kulturore**, deklarojnë se të drejtat e njeriut nuk mund të aplikohen ndaj grave në mënyrë të njëjtë si ndaj të tjerëve. Deklarata dhe Plani Veprues i Konferencës Botërore të Vjenës, kanë pranuar ekzistimin e qasjeve të ndryshme të bazuara në faktorë historikë, fetarë dhe kulturor në procesin e jetësimit të të drejtave të njeriut, por në të njëjtën kohë kanë theksuar obligimin e të gjitha shteteve për implementimin e të gjitha drejtave. Prandaj ekzistimi i dallimeve kulturore dhe fetare nuk mund të përdoret si arsyetim për mosimplementimin e plotë të obligimeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Kjo nënkupton se duhet të merret parasysh edhe konteksti kulturor. **Dialogu për civilizimet**, i cili aktualisht është duke u zhvilluar në Kombet e Bashkuara, ka për qëllim pikërisht, pranimin e vlerave pozitive që dalin nga dallimet e civilizimeve, pa ofruar arsyetim për mospërbushjen e obligimeve të tyre. Pozita e femrave brenda disa kulturave, është një nga çështjet më të vështira që duhet të jetë pjesë e çdo agjende të diskutimeve.



## E. STANDARDET E TË DREJTAVE TË NJERIUT NË NIVEL UNIVERSAL

Historia aktuale e vënies së standardeve në nivel global ka filluar me **Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut (UDHR)**, të miratuar me 10 dhjetor 1948 nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, si pasojë e Luftës së Dytë Botërore, gjatë së cilës janë parë shkeljet më të mëdha të të drejtave që kanë ndodhur ndonjëherë. Parandalimi dhe ndëshkimi i gjenocidit, sikurse ai ndaj hebrenjve, që ka ndodhur gjatë holokaustit, është objekt i “*Konventës për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimeve të Gjenocidit*”, të miratuar vetëm një ditë më herët se UDHR.

Duke dashur që përkushtimet e theksuara në UDHR të përkthehen në gjuhë të obligimeve ligjore, Komisioni i OKB-së për të Drejta të Njeriut, hartoi dy **Pakte**, një për të drejtat civile dhe politike (ICCPR) dhe një për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore (ICESCR). Për shkak të *Luftës së Ftohtë*, ato janë miratuar tek në vitin 1966 dhe pasi që janë ratifikuar nga 35 shtete, në vitin 1976, kanë hyrë në fuqi. Më 1 Janar të vitit 2003, këto pakte kanë pasur 149, respektivisht 146 shtete anëtare. Së pari është miratuar ICESCR si preferencë e shumicës së shteteve të reja socialiste në zhvillim për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore.

Gjatë viteve të 60-ta, lufta kundër **diskriminimit** racor dhe **aparteidit**, arriti kulminacionin, që rezultoi me dy konventa: atë kundër diskriminimit racor dhe ndalimin e krimeve të aparteidit. Më pas, janë miratuar konventa tjera për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër gruas, torturës dhe trajtimeve ose dënimeve tjera mizore, çnjerëzore dhe poshtëruese dhe konventa për të drejtat e fëmijëve. Këto konventa sqaruan dhe saktësuan më tutje nenet e pakteve, si dhe përqendruan vëmendjen në nevojat njerëzore të grupeve të caktuara. Në rastin e konventës së grave të vitit 1979, “*problemi i rezervave*”, që është problem i përgjithshëm i traktateve mbi të drejtat e njeriut, përfitoi rëndësi të posaçme, kur një numër i shteteve islamike bënë përpjekje që në këtë mënyrë të kufizojnë të drejtat elementare të grave.

Shtetet, sipas **parimit të mosdiskriminimit**, duhet të respektojnë dhe t'u sigurojnë të gjithë individëve brenda territorit të tyre, të gjitha të drejtat pa asnjë lloj diskriminimi, të bazuar qoftë në racë, ngjyrë, gjini, gjuhë, religjion, opinion politik ose tjetër, origjinë kombëtare ose sociale, pronë, lindje ose ndonjë status tjetër (Neni 2 ICCPR dhe ICESCR). Për më tepër, Protokoli Shtesë Nr. 12 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ofron të drejtën e përgjithshme për mosdiskriminim nga ana e çfarëdo autoriteti publik.

Sidoqoftë, ekziston mundësia e **përgjashtimeve** dhe e përdorimit të **tërheqjes nga klauzolat**. Në rastet e **jashtëzakonshme** ose të kërcënimit ndaj kombit, nëse gjendja e jashtëzakonshme shpallet zyrtarisht dhe nëse ndërmerren masa brenda kufijve të domosdoshëm të situatës së krijuar, shteti mund të tërhiqet nga disa obligime të tij. Masat e tilla duhet të merren në baza jodiskriminuese (Neni 4 (1) ICCPR). Për këto raste, ekzistojnë procedura të cila duhet të respektohet, siç është ajo e njoftimit të shteteve të tjera anëtare përmes Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Sidoqoftë, nuk lejohet asnjë kufizim nga disa dispozita siç janë ato mbi të drejtën për jetë, ndalimin e torturës dhe skllavërisë, joretroaktivitetin e veprave penale, lirinë e të menduarit, ndërgjegjes dhe të besimit (Neni 4 (2) ICCPR), etj. Kështu që, këto të drejta njihen si të drejta të patjetërsueshme. Këto dispozita emergjente, kanë përfituar një rëndësi më të madhe në luftën kundër **terrorizmit**. Dispozita të ngjashme gjenden edhe në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Neni 15). Komisioni i OKB-së për të Drejtat Civile dhe Politike, në Komentin e Përgjithshëm (Nr. 29, 2001), ka sqaruar detyrimet shtetërore në rastet e *“gjendjes së jashtëzakonshme (Neni 4)”*, gjithashtu Komisioni Interamerikan për të Drejtat e Njeriut dhe Komiteti Drejtues për të Drejtat e Njeriut në Këshillin e Evropës, kanë miratuar një raport dhe një udhëzim lidhur me *“Terrorizmin dhe të Drejtat e Njeriut”*.

Disa të drejta mund të përmbajnë të ashtuquajturën “klauzolë për tërheqje”, e cila lejon kufizimin e të drejtave të caktuara, nëse është e domosdoshme për siguri kombëtare, rend publik, shëndet publik ose moral dhe për shkak të drejtave dhe lirive të tjerëve. Mundësia e tillë, në veçanti, ekziston për kufizimin e lirisë së lëvizjes, lirisë për të lëshuar çdo vend, duke përfshirë vendin e vet, lirisë së mendimit, ndërgjegjes, besimit, lirisë së

shprehjes dhe informimit, lirisë e tubimit dhe atë të bashkimit. Këto kufizime duhet të bëhen me ligj, që do të thotë se duhet të kalojnë në kuvend. Organet që bëjnë interpretimin e këtyre instrumenteve ligjore, e kanë për obligim kontrollin e çdo keqpërdorimi të këtyre dispozitave. Si pasojë e aplikimit të gjendjes së jashtëzakonshme dhe klauzolës për tërheqje, disa raste janë paraqitur në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Komisionit dhe Gjykatës Interamerikane.



## **RISHIKIMI I KONVENTAVE MË TË RËNDËSISHME TË OKB-së PËR TË DREJTAT E NJERIUT**

- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (1948)
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (1966)
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (1966)
- Konventa për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit (1948)
- Konventën kundër Torturës dhe Trajtimit apo Dënimit tjetër Mizor, Çnjerëzor dhe Poshtëruar (1984)
- Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (1965)
- Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (1979)
- Konventa për të Drejtat e Fëmijës (1989)



## **F. IMPLEMENTIMI I INSTRUMENTEVE UNIVERSALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT**

Shtetet kanë **detyrim të respektojnë, mbrojnë dhe përmbushin** të drejtat e njeriut. Në shumë raste, implementimi nënkupton obligimet që shteti dhe autoritetet e tij kanë për përmbushjen e të drejtave të pranuar, siç është respektimi i së drejtës për privatësi ose lirisë së shprehjes. Kjo vlen sidomos për të drejtat civile dhe politike, deri sa implementimi për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, nënkupton plotësimin e tyre përmes veprimeve pozitive të shtetit, me qëllim të sigurimit të një minimumi të standardeve, siç janë dhurimi ose ofrimi i shërbimeve të caktuara si arsimimi ose shëndetësia. Në këto raste, merren parasysh edhe kapacitetet e shtetit përkatës. Për

shembull, Neni 13 i ICESCR-së njih të drejtën e përgjithshme për arsimim. Sidoqoftë, ky nen saktëson se, vetëm arsimimi fillor duhet të ofrohet falas. Ndërsa, arsimi i mesëm dhe i lartë, duhet t'ju mundësohet dhe ofrohet të gjithëve, mirëpo shkollimi i tillë falas ofrohet vetëm në mënyrë progresive. Për disa të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore, varësisht prej kapaciteteve ekzistuese, aplikohet koncepti mbi plotësimin gradual të tyre.

**Detyrimi për të mbrojtur**, kërkon nga shteti që brenda territorit të tij të parandalojë dhunën dhe shkeljet e tjera të të drejtave të njeriut. Prandaj, të drejtat e njeriut, gjithashtu, kanë “*dimensionin horizontal*”, i cili duke ngritur çështjen e përgjegjësisë sociale të kompanive transnacionale, është duke fituar rëndësi në këtë kohë të globalizimit.

Një tjetër zhvillim është ngritja e interesimit për **parandalimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut**, duke marrë masa shtetërore përmes institucioneve kombëtare ose duke përfshirë dimensionin e të drejtave të njeriut nëpër misionet **paqëruajtëse**. Synimi për parandalim është gjithashtu prioritet i **qasjes së sigurisë njerëzore** ndaj të drejtave të njeriut. 🤝 Të Drejtat e Njeriut dhe Siguria Njerëzore.

Para së gjithash, të drejtat e njeriut duhet të implementohen në **nivel kombëtar**. Sidoqoftë, mund të paraqiten **pengesa**, siç është mungesa e “*qeverisjes së mirë*”, ose prania e korrupsionit dhe joefektivitetit të administratës ose gjyqësisë. Për t'u siguruar që shtetet kanë plotësuar obligimet që dalin nga shumica e konventave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, është themeluar **monitorimi ndërkombëtar** për performansë. Ky monitorim mund të bëhet në mënyra të ndryshme. Për shumë konventa është themeluar **sistemi i raportimit**. Në bazë të këtij sistemi, shtetet kanë obligim që brenda intervaleve të caktuara kohore të raportojnë mbi të drejtat e njeriut. Zakonisht, një komision i përbërë nga ekspertët, shqyrton raportet dhe bën rekomandime për përforsimin e implementimit. Gjithashtu, komisioni mund të bëjë “*komente të përgjithshme*” lidhur me interpretimin e drejtë të konventës. Në disa raste, siç është rasti me Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR), ekziston edhe një protokol shtesë, i cili autorizon Komitetin për të Drejtat e Njeriut të pranojë **ankesa individuale**, nga personat të cilët pohojnë se u janë shkelur të drejtat e njeriut. Sidoqoftë, kjo është e mundur vetëm për personat që jetojnë në shtetet që kanë ratifikuar protokolin shtesë. Disa konventa, gjithashtu përmbajnë dispozita për **ankesa ndërshtetërore**, mirëpo kjo mundësi është përdorur

rrallë. **Procedura gjyqësore**, ekziston vetëm sipas Konventës Evropiane dhe Interamerikane për të Drejtat e Njeriut, në të cilat raste Gjykata Evropiane dhe ajo Interamerikane për të Drejtat e Njeriut, kanë mundësi përmes vendimeve të detyrueshme t'i detyrojnë shtetet. Gjithashtu, do të themelohet edhe Gjykata Afrikane e të Drejtave të Njeriut dhe Popujve pasi që satuti i saj të hyjë në fuqi.

Përveç procedurave që gjenden në instrumentet e të drejtave të njeriut siç janë, konventat, gjithashtu ekzistojnë edhe të ashtuquajturat "*Procedura të bazuara në Kartë*", të cilat janë zhvilluar në bazë të Kartës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, me qëllim të shqyrtimit të shkeljeve të të drejtave të njeriut në mbarë botën. Njëra nga ato bazohet në Rezolutën 1235 të vitit 1967, miratuar nga Këshilli Ekonomik dhe Social (ECOSOC), e cila lejon Komitetin për të Drejtat e Njeriut në procedurë publike të trajtojë shkeljet e rënda dhe sistematike të drejtave të njeriut në mbarë botën. Tjetra është procedura e fshehtë 1503 e ECSOSC-ut e vitit 1970, e cila lejon që ankesat të dërgohen te Komesari i OKB-së për të Drejtat e Njeriut në Gjenevë, të cilat më pas shqyrtohen nga një grup ekspertësh të Nënkomisionit të OKB-së për Përkrahjen dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut. Kjo procedurë parashihet kryesisht për shkeljet të rënda të të drejtave të njeriut. Në raste të tilla, Komiteti për të Drejtat e Njeriut, gjithashtu, mund t'i diskutojë situatat nga një vend i caktuar.

Gjatë punës së **Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe Nënkomisionit** të tij, rëndësi të dukshme kanë fituar **procedurat speciale**, siç janë aktivitetet e raportuesve special dhe përfaqësuesve të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, si dhe të përfaqësuesve të Sekretarit të Përgjithshëm. Ekzistojnë "*raportuesit e shteteve*" dhe "*raportuesit tematik*", siç janë raportuesit special për Bosnjën dhe Hercegovinën, Republikën Federale të Jugosllavisë, Afganistanin, Haitin si dhe raportuesit special për torturë ose dhunë ndaj grave. Në tërësi, ekzistojnë përafërsisht rreth 40 institucione të specializuara, të cilat mbledhin informata nga fusha e aktiviteteve të tyre, qoftë në një shtet ose në mbarë botën. Këto institucione reflektojnë aktivitetin e shtuar të Kombeve të Bashkuara dhe gjithashtu ofrojnë mekanizma monitoruese dhe përcjellëse për raste siç është ai i Deklaratës së Mbrojtësve të të Drejtave të Njeriut, ose siç është rasti me disa të drejta ekonomike dhe sociale, si të

drejtën për arsim, ushqim, strehim adekuat, shëndetësi, politika të adaptimit shtetëror dhe borxhe të jashtme, ku procedurat zbatuese nuk janë të parapara, ose u mungon efektiviteti. Për më tepër, gjithashtu, ekzistojnë edhe “*ekspertë të pavarur*” të së drejtës për zhvillim dhe “*grupe punuese*” për zhdukjet e dhunshme dhe të detyrueshme.

Përveç kësaj, Komesari i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, për themelimin e **misioneve të Zyrës së Komesarit të Lartë**, mbështetet fuqishëm në shtetet me gjendje problematike në fushën e të drejtave të njeriut. Misione të tilla janë themeluar në vendet si Afganistan, Bosnjë-Hercegovinë, Kamboxhi, Kolumbi, Guatemalë, Haiti, Kosovë, Mali të Zi, Serbi, Siera Leone etj. Këto misione mbledhin informata dhe duke ofruar këshilla përgjatë proceseve të reformës legislative, ose duke marrë pjesë në punën e bashkësisë ndërkombëtare bëjnë promovimin e standardeve të të drejtave të njeriut. Aktivitetet e këtyre institucioneve të specializuara kanë dy qëllime, atë promovimit dhe atë mbrojtjes. Këto aktivite përkrahin një vetëdije më të lartë për të drejtat e njeriut dhe përfshirjen e tyre në gjitha aktivitetet, me qëllim që gjitha vendimet të mbështeten fort mbi bazat e të drejtave të njeriut. **Promovimi i të drejtave të njeriut**, në të vërtetë nënkupton një detyrë shumë të madhe, e cila nuk mund të përmbushet vetëm nga institucionet dhe trupat ndërkombëtare. Para së gjithash, promovimi i të drejtave të njeriut nënkupton vetëdijësimin, informimin dhe mësimin e njerëzve për të drejtat e tyre dhe për mënyrën më të mirë të shfrytëzimit të tyre. Për këtë arsye, në këtë proces mund të përfshihen pjesëmarrës të ndryshëm, si universitetet, sektori i përgjithshëm i arsimimit, por gjithashtu edhe organizatat joqeveritare (OJQ-të).

Për **nivelin kombëtar**, Kombet e Bashkuara kanë rekomanduar themelimin e “*institucioneve kombëtare*” për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si ombudspersonin ose komisionet nacionale për të drejtat e njeriut. Për këtë qëllim, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së ka miratuar një numër të parimeve lidhur me kompetencat, përgjegjësitë, garancionet për pavarësi, pluralizëm dhe metoda të veprimit për këto institucione (Rezoluta 48/134 e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, e 20 dhjetorit 1993).



## G. TË DREJTAT E NJERIUT DHE SHOQËRIA CIVILE

Në zhvillimin e sistemit të të drejtave të njeriut, roli i shoqërisë civile, e cila kryesisht është përfaqësuar nga organizatat joqeveritare (OJQ-të), ka qenë vendimtar. OJQ-të themelohen duke u bazuar në lirinë e bashkimit, e cila mbrohet me Nenin 22 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR). Brenda shoqërisë civile, OJQ-të janë subjekte kyçe në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Në Kombet e Bashkuara, ato janë shndërruar në një lloj të “*ndërgjegjes botërore*”. Shpesh, OJQ-të përcjellin mbrojtjen e interesave konkrete si, lirinë e të shprehurit dhe lirinë e mediave (**Neni 19**), ose parandalimin e torturës dhe trajtimit çnjerëzor dhe poshtëruës (**Organizata për Parandalimin e Torturës, APT**). OJQ-të siç është **Amnesty International**, me qëllim të vendosjes së presionit mbi qeveritë, përdorin procedura të veçanta sikurse “*veprimi urgjent apelues*”. Shumë efektive mund të jetë edhe strategjia e “*mobilizimit të turpit*”, e ndihmuar nga mediat e pavarura. OJQ-të siç janë, **International Helsinki Federation (IHF)**, **International Crisis Group (ICG)** ose **Human Rights Watch (HRW)**, përmes raporteve shumë kualitative, të bazuara në fakte dhe monitorime, bëjnë influencimin e qeverive dhe bashkësisë ndërkombëtare. Një qasje tjetër dhe efektive e OJQ-ve, është hartimi i “*raporteve paralele*”, krahas raporteve zyrtare që bëjnë shtetet për trupat monitoruese ndërkombëtare.

Në bazë të një rezolute të Asamblesë së Përgjithshme të vitit 1998, **Deklaratës së Mbrojtësve për të Drejtat e Njeriut**, njerëzve dhe OJQ-ve, që punojnë për të drejtat e njeriut, duhet siguruar lirinë e nevojshme për kryerjen e punës së tillë dhe duhet të mbrohen nga çfarëdo lloj dënimi. Në disa shtete, organizatat si ajo Amnesty International ose Komiteti i Helsinkit, kanë qenë subjekte të kritikës për punën e tyre, kurse në disa vende edhe subjekte të dënimeve. Në mbarë botën, ka pasur raste të shumta kur aktivistët e të drejtave të njeriut për punën e tyre legale që kanë bërë janë burgosur. Shteti nuk ka vetëm obligim t’i mbrojë këta aktivist nga autoritetet e tij siç është policia, por edhe nga grupet e dhunshme, siç janë grupacionet vrastare, të cilat e marrin ligjin në duart e tyre.

Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së ka emëruar *Përfaqësuesin Special* për Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut, me qëllim të përkrahjes së implemtimit të kësaj deklaratë të OKB-së. Shpesh, OJQ-të në bashkëpunim me Kombet e Bashkuara, UNESCO-n, Këshillin e Evropës dhe me organizata të tjera ndërqeveritare, ose përmes zhvillimit të

planprogrameve, organizimit të programeve trajnuese, ose përgatitjes së materialeve trajnuese, luajnë rolin kryesor në *Arsimimin dhe Mësimin për të Drejta të Njeriut* (HREL). Në nivel global, Dekada Popullore për Arsimim të Njerëzve (PDHRE), e cila ka inicuar Dekadën e OKB-së për të Drejtat e Njeriut, ka arritur edhe në viset jugore si Indi, Argjentinë dhe Mali. Ndërkaq, aktive në fushën e trajnimit kundër racizmit dhe sjelljeve diskriminuese në gjithë botën është Liga e Anti-Shpifjes.

Rrjeti i OJQ-ve, ka fituar një rëndësi të posaçme në luftën për barazinë e grave dhe mbrojtjen e tyre. OJQ-të si UNIFEM-i, CLADEM-i dhe WIDE, me qëllim të forcimit të grave për tejkalimin e pengesave të barazisë dhe mosdiskriminimit të plotë, kanë vendosur Arsimimin dhe Mësimin për të Drejta të Njeriut (HRLE) lart në agjendën e tyre. Në Afrikë, para sesionit të Komisionit Afrikan për të Drejtat e Njeriut dhe Popujve, OJQ-të takohen rregullisht, përcjellin sesionet e tij dhe gjithashtu organizojnë trajnime të përbashkëta. OJQ-ja Austriake–Qendra Evropiane e Trajnimeve dhe Hulumtimeve për të Drejtat e Njeriut dhe Demokraci, bashkëpunon me një numër të qendrave tjera për të drejta të njeriut në Evropën juglindore, duke ofruar programe lokale dhe rajonale të karakterit edukues dhe trajnues. Gjithashtu, kjo organizon edhe një Akademi Verore Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut dhe Sigurisë Njerëzore.

## **H. SISTEMET RAJONALE PËR MBROJTJEN DHE PROMOVIMIN E TË DREJTAVE TË NJERIUT**

Përveç instrumenteve universale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, gjithashtu janë zhvilluar edhe disa sisteme rajonale të të drejtave të njeriut, të cilat zakonisht ofrojnë standarde më të larta për të drejtat dhe implementimin e tyre.

Përparësia e sistemeve rajonale qëndron në mundësinë e tyre për adresim më efektiv të ankesave. Në rastin e gjykatave mund të nxirren vendime të karakterit të detyrueshmëm për kompensim dhe, në përgjithësi, rekomandimet e Komisioneve për të Drejtat e Njeriut merren seriozisht nga ana e shteteve. Mund të ndodhë që shtetet jo vetëm të interpretojnë dhe sqarojnë dispozitat e instrumenteve për të drejtat e njeriut në “*rastet kryesore*”, por edhe të ndryshojnë ligjet nacionale, me qëllim të harmonizimit të tyre me detyrimet

ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Për më tepër, sistemi rajonal ka tendencë të jetë më sensitiv ndaj problemeve kulturore dhe fetare, nëse ekzistojnë arsye të tilla.



## I. EVROPA

Sistemi evropian i të drejtave të njeriut ka tri nivele, sistemin e Këshillit të Evropës (momentalisht ka 45 anëtarë), Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (55 anëtarë) dhe Bashkimin Evropian (momentalisht 15 anëtarë, *në Maj pritet të rritet në 25 anëtar*).

Sistemi Evropian i të drejtave të njeriut është sistemi më i përpunuar rajonal. Ai është zhvilluar si reagim ndaj shkeljeve masive të të drejtave të njeriut gjatë Luftës së Dytë Botërore. Thelbin e rendit ligjor evropian e përbëjnë të drejtat e njeriut, sundimi i ligjit dhe demokracia pluraliste.

### INSTRUMENTET EVROPIANE TË TË DREJTAVË TË NJERIUT

- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (1950) dhe 13 protokolet shtesë
- Karta Sociale Evropiane (1961) e rishikuar më 1991, 1996 dhe Protokolet shtesë të 1988 dhe 1995.
- Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtmjit apo Dënimit Çnjerëzor dhe Poshtëruar (1987).
- Akti Final i Helsinkit dhe procesi vazhduar CSCE/OSCE me Kartën e Parisit për Evropën e Re (1990).
- Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale dhe Minoritare (1992).
- Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare (1994) .
- Karta e Bashkimit Evropian për të Drejtat Fundamentale (2000).

### 1. SISTEMI I KËSHILLIT TË EVROPËS PËR TË DREJTAT E NJERIUT

#### a. Vështrim

Instrumenti kryesor i Këshillit të Evropës është **Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut** e vitit 1950 dhe 13 protokolet shtesë të saj. Protokoli Nr. 6 dhe 13 (i cili ende nuk ka hyrë në fuqi), për heqjen e dënimit me vdekje, që edhe e dallon qasjen evropiane për të drejtat e njeriut ndaj asaj Amerikane dhe protokoli Nr. 11, i cili ka zëvendësuar

Komisionin Evropian për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut me një Gjykatë të Përhershme për të Drejtat e Njeriut, janë të një rëndësie të veçantë. Konventa Evropiane kryesisht përmban të drejta civile dhe politike.

**Karta Sociale Evropiane** e vitit 1961 është nxjerrë me qëllim të shtimit të të drejtave ekonomike dhe sociale, por kurrë nuk ka fituar rëndësi sa Konventa Evropiane. Që nga fillimi ajo ka vuajtur nga sistemi i dobët dhe joefektiv për implementim. Sidoqoftë, nga fundi i viteve të 1980-ta, krahas rritjes së vëmendjes për të drejtat ekonomike dhe sociale në nivel universal, një vëmendje e re, gjithashtu, i është përkushtuar Kartës Sociale Evropiane, e cila është amenduar dy herë, më 1988 dhe 1995, e cila duke u bazuar në protokolin shtesë tani ofron mundësi edhe për ankesa kolektive.

Risia kryesore është paraqitur me **Konventën Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit apo Dënimit Çnjerëzor dhe Poshtëruës** të vitit 1987, e cila themelon Komitetin Evropian për parandalimin e torturës dhe trajtimit apo dënimit çnjerëzor dhe poshtëruës, dërgon delegacione të të gjitha shtetet anëtare të konventës për zhvillim të vizitave të rregullta ose jashtëzakonshme të të gjitha burgjeve. Prandaj, logjika e këtij sistemi është efekti i tij prandalues, me gjithë mbrojtjen *ex post facto*, për të cilën ende kujdeset Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe gjykata e saj. Në dhjetor të 2002-tës, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi një protokol shtesë kundër torturës, i cili parasheh një mekanizëm të ngjashmë për veprim në mbarë botën.

**Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare** (1995) është hartuar pas takimit të lartë të Këshillit të Evropës në Vjenë më 1993, si reaksion ndaj rritjes së problemeve të minoriteteve në Evropë. Këto probleme janë paraqitur si rezultat i shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik, Republikës Socialiste të Jugosllavisë dhe procesit të vetëvendosjes në Evropë gjatë vitetve të 1990-ta.

Në pajtim me konventën, shtetet duhet të mbrojnë të drejtat individuale të minoriteteve kombëtare, por gjithashtu duhet të ofrojnë kushte të cilat u lejojnë minoriteteve të ruajnë dhe zhvillojnë identitetin e tyre. Sido që të jetë, mekanizmi zbatues është i kufizuar në shtetin e raportimit dhe shqyrtimin e raportve nga Komiteti Këshilles i Ekspertëve.



## INSTITUCIONET DHE INSTRUMENTET EVROPIANE PËR TË DREJTAT NJERIUT

### **Këshilli i Evropës:**

- Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (si Gjykatë e vetme nga 1998)
- Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale (i rishikuar më 1999)
- Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit apo Dënimit Çnjerëzor dhe Poshtëruës (CPT 1989)
- Komiteti Këshillues i Konventës Kornizë për Minoritete Kombëtare (ECRI 1993)
- Komesari Evropian për të Drejtat e Njeriut (1999)
- Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës.

### **OSBE:**

- Zyra për Institucione Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut (ZIDDNJ, 1990)
- Komesari i Lartë për Minoritete Kombëtare (OSCE, 1992)
- Përfaqësuesi për Lirinë e Mediave (OSCE, 1997).

### **Bashkimi Evropian:**

- Gjykata Evropiane e Drejtësisë
- Qendra Monitoruese Evropiane për Racizëm dhe Ksenofobi (EUMC, 2000)
- Karta e Bashkimit Evropian për të Drejtave Fundamentale (2000)

Këshilli i Evropës në vitin 1999, gjithashtu ka themeluar “*Komesarin për të Drejtat e Njeriut*”, i cili informon mbi punën e tij/saj në raport vjetor. Përveç kësaj, për punën e anëtarëve nga fushat e ndryshme të të drejtave të njeriut, ekziston “**sistemi i monitorimit konfidencial**” për të cilin, në bazë të raporteve të përgatitura nga Sekretariati është përgjegjës Këshilli i Ministrave.

### **b. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut**

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në Strasburg, jurisdikcioni i detyrueshëm i së cilës sot pranohet nga të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, është instrumenti kryesor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Numri i gjyqtarëve është i njëjtë me numrin

e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës. Në secilin rast involvohet edhe një i ashtuquajtur “*gjiqtar vendor*”, me qëllim të lehtësimit të kuptimit të legjislacionit vendor. Sidoqoftë, secili gjiqtar i emëruar vepron në kapacitetin e tij/saj peronal.

Në mënyrë që një ankesë të jetë e **pranueshme**, duhet të plotësohen katër parakushte kryesore:

- a. Shkelja e një të drejte të mbrojtur me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (ECHR) dhe protokolet e saj
- b. Parashtruesi(t) të jetë (janë) viktimë/a e asaj shkeljeje
- c. Shfrytëzimi i gjitha mjeteve juridike efektive vendore
- d. Ankesa të bëhet brenda afatit kohor më të shkurtër se gjashtë muaj pas përdorimit të plotë të mjeteve vendore

Në qoftë se rasti konsiderohet i pranueshëm, një dhomë e përbërë nga 7 gjiqtarë vendos mbi bazën e rastit. Aktvendimi i tyre lidhur me atë nëse rasti konsiderohet veçanërisht i rëndësishëm ose paraqet ndonjë risi për juridiksionin ekzistues është final, me ç’rast dhoma e madhe prej 17 gjiqtarëve e shqyrton kërkesën.

Aktgijkimet janë të detyrueshme dhe gjithashtu mund të ofrojnë kompensim të dëmeve. Implementimi i aktgijkimeve është detyrë e Komitetit të Ministrave, i cili bën mbikëqyrjen e ekzekutimit të aktgijkimeve të Gjykatës. Për momentin, problemin kryesor të këtij sistemi e paraqesin numri shumë i lartë i ankesave, i cili është rritur nga 1000 sa ishin përafërsisht në vitin 1998, në 29.000 në vitin 2002, duke rezultuar në mbingarkesën e sistemit.




## **2. SISTEMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT I ORGANIZATËS EVROPIANE PËR SIGURI DHE BASHKËPUNIM NË EVROPË (OSBE)**

OSBE-ja është një organizatë e posaçme, e cila në vitin 1994 ka zëvendësuar Konferencën për Siguri dhe Bashkëpunim të Evropës. Ajo nuk ka ndonjë kartë ligjore ose subjektivitet ligjor ndërkombëtar, ndërsa deklaratat dhe rekomandimet e saj janë vetëm të natyrës politike dhe nuk janë të obligueshme për shtetet. Miërpo, katalogët mjaft të detajuar, që janë miratuar nëpër konferenca dhe takime të ekspertëve ose në konferenca të

rregullta, të cilat janë monitoruar nga Këshilli i shteteve përfaqësuese, paraqesin një meknizëm monitorues mjaft të suksesshëm. I ashtuquajtur “Procesi i Helsiniki”, gjatë luftës së ftohtë ka luajtur rolin kryesor në ndërtimin e bashkëpunimit mes Jugut dhe Perëndimit, duke ofruar një bazë për bashkëpunim të gjerë në Evropën e përbërë nga 55 shtete.

OSBE-ja në emër të “*dimensionit njerëzor*”, ka ndërmarrë një sërë aktivitete në fushën e të drejtave të njeriut dhe në veçanti në atë të të drejtave të minoriteteve. Këto aktivitete kanë qenë shumë të rëndësishme në terrene të misioneve të ndryshme të OSBE-së si në, Bosnjë-Hercegovinë, Serbi, Mal të Zi dhe në Kosovë. Për këtë arsye, misionet e OSBE-së përmbajnë departamente dhe zyrtarë për të drejtat e njeriut, të cilët shpërndahen në gjithë vendin, për të monitoruar dhe raportuar mbi gjendjen e të drejtave të njeriut, por edhe për të promovuar të drejtat e njeriut, kurse në raste të veçanta edhe për të asistuar në mbrojtje. Po ashtu, në vendet ku OSBE-ja ka misionet e veta përkrah edhe institucionet kombëtare, siç është përkrahja e ombudspersonit në Bosnjë-Hercegovinë dhe në Kosovë.

Janë zhvilluar edhe mekanizma special në formë të **Komesarit të Lartë për Minoritete dhe Përfaqësuesit për Liri të Mediave**  Moduli për Lirinë e të Shprehurit, zyret e të cilëve ndodhen në Hagë, përkatësisht në Vjenë. Komesari i Lartë për Minoritete Kombëtare është një lloj mekanizmi për parandalimin e konflikteve, me mandat që, në rast të tensioneve etnike, të angazhohet në fazën sa më të hershme. Në një numër të shteteve evropiane që po transformohen në demokraci pluraliste, OSBE-ja gjithashtu ka pasur rol kyç në monitorimin e zgjedhjeve demokratike. Procesi i demokratizimit dhe promovimit të të drejtave të njeriut përkrahet nga **Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut (ODIHR)** të vendosur në Varshavë. Gjithashtu, OSBE-ja luan rol kryesor për zgjidhjen e konflikteve dhe rindërtimit në Evropë.



### 3. POLITIKA E BASHKIMIT EVROPIAN PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Deri sa Komuniteti Ekonomik Evropian i krijuar më 1957, fillimisht gjatë viteve të 1980-ta nuk merrej me çështje politke, siç janë të drejtat e njeriut, me integrimin politik të

Evropës drejt Bashkimit Evropian, të drejtat e njeriut dhe demokracia u bënë koncepte kryesore të rendit të përgjithshëm juridik evropian. Rolin kryesor e ka luajtur **Gjykata Evropiane e Drejtësisë**, e cila ka zhvilluar juridiksionin për të drejtat e njeriut, që rrjedh si nga “*traditat e përbashkëta kushtetuese të shteteve anëtare*”, ashtu edhe nga traktatet ndërkombëtare siç është Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, palë të cilave janë gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Disa të drejta të njeriut sikurse janë, e drejta për pronë, liria e bashkimit, besimit ose parimi i barazisë, janë të një rëndësie të veçantë për të drejtën e bashkësisë evropiane. Që nga vitet e 1980-ta, Bashkimi Evropian, ka zhvilluar një politikë të të drejtave të njeriut në raport me shtetet e treta, e cila reflektohet edhe në të ashtuquajturat **kritere të Kopenhagës**, të cilat vlejné për njohjen e shteteve të reja të Evropës Juglindore. Marrëveshja e Bashkimit Evropian, e vitit 1995 shprehimisht u referohet neneve 6 dhe 7 të Konventës Evropiane të vitit 1950, edhe pse deri më tani Bashkimi Evropian nuk i është bashkangjitur kësaj konvente si palë.

Në vitin 2000, është mbledhur një asamble me qëllim të hartimit të **Kartës së Bashkimit Evropian për të Drejtat Fundamentale**, e cila u miratua në samitin e Nicës në vitin 2000. Tash për tash kjo kartë është dokumenti më modern i të drejtave të njeriut në Evropë, i cili ngjashëm me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut (UDHR) përmban si të drejta civile, politike ashtu edhe të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore. Sikurse edhe UDHR-ja, edhe kjo Kartë nuk ka karakter të detyrueshëm ligjor. Sidoqoftë, pasi që Karta përmban një numër të të drejtave të cilat gjithashtu janë pjesë e traktateve të ndryshme ndërkombëtare, palë e të cilave janë shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, kjo Kartë mund të kuptohet si një interpretim dhe sqarim i atyre obligimeve të detyrueshme. Që nga viti 1995, UE në marrëveshjet bilaterale sikurse janë “*Marrëveshja për Stabilizim dhe Asocijim*”, Marrëveshja Kotonau ose Marrëveshja Euromed, përfshijnë edhe **kaluzolën për të drejtat e njeriut**. Ekzistojné shpresat që më në fund kushtetuta Evropiane e cila mometalisht është duke u hartuar nga asambleja, do të mund t’i japë statusin e obligueshëm Kartës së Bashkimit Evropian për të Drejtat Fundamentale.

Bashkimi Evropian si pjesë të Politikës së Përbashkët për Punë të Jashtme dhe Siguri, ka hartuar një politikë mbi të drejtat e njeriut, si për marrëdhëniet e brendshme, ashtu edhe për ato të jashtmet. Në përgjithësi, **Raporti Vjetor për të Drejtat e Njeriut**, i publikuar

nga Këshilli i Bashkimit Evropian reflekton rëndësinë e kësaj politike të Bashkimit Evropian. Këshilli jep deklarata publike, por gjithashtu është aktiv tërthorazi në rastet e “*diplomacisë së të drejtave të njeriut*”, ku bashkërisht me Komisionin Evropian zhvillojnë “*dialog për të drejtat e njeriut*” me disa shtete si Kinën dhe Iranin. Parlamenti Evropian, ka marrë iniciativë për mbajtjen e çështjes së të drejtave të njeriut lart në agjendën e UE dhe gjithashtu harton raporte vjetore për të drejtat e njeriut. Në bazë të iniciativës së saj, **Iniciativa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Demokraci**, ka vënë në dispozicion përkrahje financiare për OJQ-të nga fusha e të drejtave të njeriut dhe demokracisë, të cilat në emër të Komisionit Evropian menaxhohen nga Europe Aid, i cili gjithashtu bën hartimin e strategjisë politike. Një theks i veçantë i është kushtuar luftës kundër torturës dhe dënimit me vdekje dhe kampanjës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare.

**Qendra Evropiane e Bashkimit Evropian për Monitorim të Racizmit dhe Ksenofobisë (EUMC)**, është themeluar nga Bashkimi Evropian më 1998 në Vjenë, me qëllim të trajtimit të problemeve të shtuara të racizmit dhe ksenofobisë në Evropë, si dhe për vëzhgimin e gjendjes dhe përkrahjen e aktiviteteve kundër racizmit dhe ksenofobisë. Në të njëjtin vit, në Traktatin e Komuniteteve Evropiane është inkorporuar Neni 13, duke i dhënë fuqi Bashkimit Evropian të luftojë diskriminimin e bazuar në racë, origjinë etnike, besim fetar, moshë, paaftësi ose orientim seksual. Në vitin 2000, Këshilli ka miratuar direktivën 2000/43/EC, për implementimin e parimit për trajtim të barabartë, në veçanti në fushën e punësimit, qasjen në arsim, trajnim dhe avantazhe sociale pa dallim të bazuar në racë ose origjinë etnike, të cilat aplikohen si brenda sektorit privat të UE, ashtu edhe në sektorin publik. Në mënyrë të ngjashme, Bashkimi Evropian ka interes të veçantë edhe në **barazinë**. Në pajtim me Nenin 141 të Traktatit për Themelimin e Bashkimi Evropian, shtetet anëtare duhet të aplikojnë parimin e “*pagesës së njëjtë për gratë dhe burrat*” dhe të marrin masa për ofrimin e mundësive të barabarta. Kjo gjithashtu ka qenë subjekt i rregulloreve të miratuara nga Këshilli i Evropës, të cilat kanë rëndësi të veçantë në marrëdhëniet e punës.



## II. AMERIKANËT

Sistemi Interamerikan i të Drejtave të Njeriut, ka filluar me **Deklaratën Amerikane për të Drejtat dhe Detyrat e Njeriut** të miratuar në vitin 1948, së bashku me Kartën e Organizatës së Shteteve Amerikane (OAS). Komisioni Iner-Amerikan për të Drejtat e Njeriut i themeluar në vitin 1959 nga OAS i cili përbëhet nga 7 anëtarë, paraqet organin kryesor të këtij sistemi. Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut e miratuar më 1969, ka hyrë në fuqi më 1978 dhe që atëherë është plotësuar me dy protokole shtesë, një për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore dhe tjetri për heqjen e dënimit me vdekje. Edhe pse selia e Komisionit është në Washington, Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk janë anëtare të Konventës. Konventa, gjithashtu parashikon Gjykatën Interamerikane për të Drejtat e Njeriut, e cila është themeluar në vitin 1979 me seli në Kosta Rikë, ku ndodhet edhe “*Instituti Interamerikan për të Drejtat e Njeriut*”.

Ekzistojnë disa instrumente ligjore që u japin grave të drejta, por vëmendje të veçantë meriton **Konventa Interamerikane për Parandalimin, Dënimin dhe Çrrënjosjen e Dhunës ndaj Grave (Konventa e Belem do Para)**, e cila ka hyrë në fuqi në vitin 1995. Deri më tani, konventën e kanë nënshkruar 31 nga 34 shtete anëtare të OAS. Në bazë të kësaj Konvente, shtetet duhet t'i paraqesin **Komisionit Interamerikan të Grave**, të themeluar qysh nga viti 1928, raporte të rregullta kombëtare. Ekziston gjithashtu, **Raportuesi Special për të Drejtat e Njeriut** (që nga viti 1994).

#### @ SISTEMI INTERAMERIKAN I TË DREJTAVE TË NJERIUT

- Deklarata Amerikane për të Drejtat dhe Obligimet e Njeriut (1948)
- Komisioni Interamerikan për të Drejtat e Njeriut (1959)
- Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut (1969/1978)
- Protokoli Shtesë për të Drejta Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (1988)
- Protokoli Shtesë për Heqjen e Dënimit me Vdekje (1990)
- Gjykata Interamerikane për të Drejtat e Njeriut (1979/1984)
- Komisioni Interamerikan për Gratë (1928)
- Konventa Interamerikane për Parandalimin, Dënimin dhe Çrrënjosjen e Dhunës ndaj Grave (1994)

Në Komisionin Interamerikan për të Drejtat e Njeriut, ankesat e quajtura “*kërkesa*”, mund t’i parashtrijnë, individët, grupet ose OJQ-të, prej të cilave, komisioni mund të kërkojë informata për masat e ndërmarra për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Gjykata Interamerikane nuk mund të qaset drejtpërdrejt, por vetëm përmes Komisionit, i cili vendos se cilat raste duhet të transferohen në Gjykatë. Në bazë të kësaj rruge, Gjykata në të kaluarën nuk ka pasur shumë raste, mirëpo tani duket se ka ndryshuar. Gjykata, gjithashtu, mund të japë mendime këshilluese, si interpretimet e Konventës. Sikurse Komisioni, edhe Gjykata ka 7 anëtarë dhe punon në baza jo të përhershme.

Komisioni mund të ndërmarrë hetime në vendin e ngjarjes dhe mund të hartojë raporte speciale për çështjet me interes të posaçëm. Ekzistojnë disa OJQ, të cilat ndihmojnë viktimat e dhunës së të drejtave të njeriut të dërgojnë rastet në Komisionin Interamerikan për të Drejtat e Njeriut dhe në Gjykatës.



### III. AFRIKA

Sistemi Afrikan i të drejtave të njeriut është themeluar në vitin 1981, me miratimin e Kartës Afrikane për të Drejtat e Popujve, e cila ka hyrë në fuqi në vitin 1986, nga atëherë e quajtura Organizata e Unitetit Afrikan (OUA). Kjo Kartë parashikon **Komisionin Afrikan për të Drejtat e Njeriut dhe të Popujve**, që përbëhet nga 11 anëtarë dhe e ka selinë në Banjul të Gambisë. Sot, të 53 shtetet e Unionit Afrikan (UA), i cili ka trashëguar OUA-në në vitin 2001, kanë ratifikuar Kartën Afrikane, e cila duke marrë për bazë Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, bënë bashkimin e gjitha të drejtave në një dokument. Preambula e saj u referohet “*vlerave të civilizimit Afrikan*” duke tentuar të inspirojë konceptin afrikan të të drejtave të njerëzve dhe popujve. Përveç të drejtave individuale, ajo gjithashtu parashtron edhe të drejtat e popujve. Për më tepër, ajo thekson edhe detyrimet si p.sh. ato ndaj familjes dhe shoqërisë, të cilat sido që të jetë, në praktikë nuk kanë ndonjë rëndësi.



### SISTEMI AFRIKAN I TË DREJTAVE TË NJERIUT

- Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe të Popujve (1981)
- Komisioni Afrikan për të Drejtat e Njeriut (1987)

- Protokoli mbi Themelimin e një Gjykate Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe Qytetarëve (më 1997, ende nuk është në fuqi)
- Protokoli për të Drejtat e Grave (ende nuk është miratuar nga UA)
- Karta Afrikane për të Drejtat dhe Mirëqenien e Fëmijës (1990)

Komisioni ka një mandat të gjerë në fushën e promovimit të të drejtave të njeriut, por gjithashtu mund të pranojë ankesa nga shtetet (që nuk ka ndodhur deri tani), individët ose grupet e caktuara. Kriteret e pranimit janë të numërta, por lejojnë gjithashtu OJQ-të ose individët të komunikojnë në emër të viktimave të dhunës. Sidoqftë, Komisioni nuk mund të nxjerrë vendime me fuqi obligative dhe kjo ka qenë një nga arsytet për miratimin e protokolit shtesë të Kartës mbi themelimin e **Gjykatës Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe Qytetarëve**, që do të hyjë në fuqi pasi të ratifikohet nga 15 shtete. Kjo gjykatë do të përbëhet nga 15 gjyqtarë. Sidoqftë, individët do të kenë qasje të drejtpërdrejtë në gjykatë, vetëm nëse shtetet deklarohen shprehimisht për këtë. Përndryshe, Gjykata mund të pranojë ankesa vetëm përmes Komisionit, ashtu si edhe në Sistemin Interamerikan.

Monitorimi i rregullt i gjendjes së të drejtave të njeriut, duhet të bëhet nga Komisioni, duke i vlerësuar **raportet** shtetërore, të cilat shpesh janë jo të rregullta dhe të mangëta. Komisioni, duke u bazuar përsëri në praktikën e OKB-së, ka emëruar **raportuesin special për ekzekutime të paligjshme, jashtëprocedurale dhe arbitrare, raportuesin special për burgje**, atë për **kushtet e arrestit** dhe për **gratë**. Plani për **protokolin shtesë për të drejtat e grave**, ende nuk është materializuar.

Komisioni, gjithashtu dërgon **misione për hulumtimin e fakteve** dhe në raste të veçanta, sikurse ai i vitit 1995 pas ekzekutimit të nëntë anëtareve të Lëvizjes për Mbijetimin e Popullit Ogoni, në një gjykim të padrejtë, organizon edhe **sesione të jashtëzakonshme**. Një pjesë e rëndësishme e fuqisë së Komisionit vjen nga **Organizatat Joqeveritare** të Afrikës dhe më gjerë, të cilat lejohen të marrin pjesë në gjitha takimet publike të Komisionit. Shpesh, OJQ-të sjellin raste të shkeljeve të të drejtave të njeriut, si dhe përkrahin punën e Komisionit dhe të raportuesve të tij special. Gjithashtu, është e rëndësishme që shtetet ta bëjnë drejtpërdrejt të aplikueshme Kartën në **sistemet e tyre nacionale**. Kjo ka ndodhur për shembull në Nigeri, ku si rezultat i OJQ-ve nigeriane, siç

është “*Projekti i të Drejtave Kushtetuese*”, janë paraqitur me sukses raste të shkeljeve të Kartës në gjykatat nigeriane.

Pas miratimit të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës më 1989, në vitin 1990 është miratuar një **Kartë Afrikane për të Drejtat dhe Mirëqenien e Fëmijës**. Sidoqoftë, kjo ka hyrë në fuqi vetëm në vitin 1999, kurse deri në vitin 2001, atë e kanë ratifikuar 27 shtete të Unionit Afrikan. Karta Afrikane parashikon edhe themelimin e një Komiteti Afrikan të Ekspertëve për të Drejtat dhe Mirëqenien e Fëmijës, i cili duhet të mbledhet së paku një herë në vit. Duke pasur parasysh procesin e gjatë të ratifikimit, mbetet të shihet nëse kjo konventë dhe komiteti i saj do të japin rezultate të mira.



#### IV. REGJIONET TJERA

Një **Kartë Arabe për të Drejtat e Njeriut**, e cila është hartuar nga ekspertët arabë të të drejtave të njeriut është miratuar në vitin 1994 nga Këshilli i *Ligës së Shteteve Arabe* (Rezoluta 5437 e 15 Shtatorit 1994), mirëpo deri në vitin 2002 nuk ka hyrë në fuqi.

Me gjithë disa përpjekje si ajo e Asociacionit të Azisë Jugore për Bashkëpunim Regjional një Konventë mbi Marrëveshjen Rajonale për Promovimin e Mirëqenies së Fëmijës 2002, dallimet e shumta që ekzistojnë brenda rajonit, e kanë bërë të pamundur miratimin e një instrumenti regjional të Azisë për të Drejtat e Njeriut, ose themelimin e një Komisioni Aziatik për të Drejtat e Njeriut. Sidoqoftë, përpjekjet që janë duke u bërë brenda fushave të integriteteve si në ASEAN ose Forum Azia-Pacific të Institucioneve Nacionale për të Drejtat e Njeriut, më në fund brenda një të ardhme të caktuar, mund të çojnë drejt krijimit të një Komisioni Aziatik për të Drejtat e Njeriut. Në nivel të shoqërisë civile, në vitin 1998 gjatë shënimit të 50 vjetorit të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (UDHR), nën udhëheqjen e **Qendrave Aziatike për Burime Ligjore** të Hong Kongut, mëse 200 OJQ aziatike, hartuan një “*Kartë Aziatike për të Drejtat e Njeriut*” si një “*Kartë të Popullit*”. Gjithashtu, ekziston një **Bisedim Euro-Aziatik**, mes Bashkimit Evropian dhe 10 shteteve të ASEM-it (Takimit Evropian dhe Aziatik) për të drejtat e njeriut, i cili deri tani ka mbajtur katër sesione. **Bisedime** të ngjashme ekzistojnë edhe ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kinës.

**Marrëveshja për Partneritet e Cotonou-s** e vitit 2000, si një marrëveshje ndërregionale, ndërmjet 78 shteteve afrikane, karibike dhe pacifike dhe 15 shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, në Nenin 9 (2) përkujton se *“respekti për të drejtat e njeriut, parimet demokratike dhe sundimin e ligjit . . . përbëjnë elementet kryesore të kësaj marrëveshjeje”*.



## **SHEMBULLI I PAKTIT TË STABILITETIT PËR EJL-në**

Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore (SEE), i nënshkruar zyrtarisht më 1999 në Sarajevë, u kushton rëndësi të veçantë të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve. Për këtë qëllim, **Grupi Punues për të Drejtat e Njeriut dhe të Minoriteteve** i këtij pakti me seli në Lubjanë, ka zhvilluar një strategji të përbashkët dhe ka bashkuar një numër të madh të aktiviteteve për përmirësimin e marrëdhënieve etnike, mbrojtjen e minoriteteve dhe të të drejtave të njeriut.

Në mesin e projekteve bashkëpunuese brenda Grupit Punues, është edhe rrjeti i qendrave për të drejta të njeriut i Evropës Juglindore, i njohur si **Rrjeti HRC i SEE**. Ky rrjet i përbërë nga 9 qendra, kryesisht të bazuara në universite dhe i koordinuar nga ETC e Gracit, së bashku me qendrën për të drejta të njeriut në Sarajevë, organizojnë trajnime në nivel vendor, shkolla verore për të drejtat e njeriut si dhe projekte hulumtuese siç është, Doracaku i të Drejtave të Njeriut për Joavokatët. Ky rrjet bën përpjekje që të kontribuojë për zhvillimin e kulturës së të drejtave të njeriut në Evropën Juglindore, duke vetëdijësuar njerëzit për të drejtat e tyre dhe duke i pajisur ata me dije për të kontribuar në transformimin e shoqërive të tyre drejt sundimit të ligjit, për të drejtat e njeriut dhe për demokraci, si tri elementet kryesore të identitetit evropian.

## **I. PROBLEMI I MOSPËRGJEGJËSISË**

Lufta kundër mospërgjegjësisë dhe ajo për përgjegjësi është shndërruar në një shqetësim të gjerë global. Një nga problemet kryesore është parandalimin i krimeve të mëtutjeshme, të cilat shpesh po marrin formën e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe të së drejtës humanitare. Praktikrat e lirimit të shkelësve më të mëdhenj të të drejtave të njeriut në botë nga **përgjegjësia**, janë bërë me qëllim që të bindin udhëheqësit jodemokratik, e më së shpeshti gjeneralët e ushtrisë që t'i transferojnë pushtetet në qeveritë e zgjedhura

në mënyrë demokratike. Kjo nuk duhet të ngatërrohet me “amnistinë”, e cila jepet menjëherë pas përfundimit të luftërave dhe ndërrimit të regjimeve për shkeljet më të vogla. Mospërgjegjësia është e kundërta e përgjegjësisë, e cila, për shembull, në nivel vendor dhe ndërkombëtar, realizohet në mënyrë të vazhdueshme përmes themelimit të tribunaleve dhe gjykatave ndërkombëtare penale, qoftë speciale qoftë të përgjithshme.

Me qëllim të parandalimit të shkeljeve të të drejtave të njeriut, konventat e caktuara ndërkombëtare, sikurse Konventa e OKB-së kundër Torturës e vitit 1948, parasheh detyrimin për **dënim universal** të kryesve të krimeve. Në rastin e ish-dikatorit të Kilit, Gjeneralit Augusto Pinoçetit (Augusto Pinochet) në vitin 1998, një gjyqtar spanjoll ka kërkuar nga Britania e Madhe ekstradimin e tij, kërkesë e cila është aprovuar me një vendim të jashtëzakonshëm të Dhomës së Lordëve, por që nuk është ekzekutuar për shkak të gjendjes së keqe shëndetësore të Pinoçetit. Parimi i jurisdiksionit universal aplikohet nga Gjykata Penale Ndërkombëtare (ICC) dhe në nivel kombëtar.

Format e tjera të **realizimit të përgjegjësisë**, pa domosdoshmërinë e ndëshkimit të kryesve, janë “Komisionet e Pajtimimit dhe të së Vërtetës”, të cilat si forma të drejtësisë jondëshkimore, janë themeluar në Afrikën Jugore dhe në shtete të tjera. Këto komisione u japin viktimave shans, që së paku ta dinë të vërtetën dhe që shoqëria të mësojë leksione nga e kaluara.

Në rastin e **Argjentinës**, Komisioni Interamerikan për të Drejtat e Njeriut ka vendosur se ligjet për amnisti, të cilat përjashtojnë përgjegjësinë, paraqesin shkelje të së drejtës për mbrojtje ligjore dhe për gjykim të drejtë. Gjithashtu, ka ekzistuar edhe një fushatë ndërkombëtare kundër mospërgjegjësisë, në të cilën OJQ-të lokale kanë luajtur rolin kryesor. Dhe si përfundim, në vitin 1998 janë hequr ligjet për amnisti.

## **J. JURISDIKSIONI NDËRKOMBËTAR PENAL**

Në bazë të statutit të **Gjykatës Ndërkombëtare Penale (ICC)**, të miratuar në Romë në vitin 1998, e cila ka hyrë në fuqi në vitin 2002, ICC-ja është themeluar si gjykatë e përhershme në Hagë. Jurisdiksioni i saj mbulon krimet e gjenocidi, krimet kundër njerëzimit “*të kryera si pjesë e sulmeve të gjëra sistematike të drejtuara kundër çdo*

*popullate civile*”, që përfshijnë rastet e dhunimit, skllavërisë seksuale, shtatzanësisë së detyrueshme, ose çfarëdo forme tjetër të dhunës së rëndë seksuale, zhdukjes së dhunshme të popujve ose akteve të ngjashme çnjerëzore që shkaktojnë vuajtje të mëdha, që mund të jenë dëmtime serioze të shëndetit mental ose shëndetit fizik.

**Tribunali Ndërkombëtar Penal për Ish-Jugosllavinë (ICTY)** me seli në Hagë, është themeluar më 1993, si gjykatë *ad hoc* nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së, që të trajtojë shkeljet masive të të drejtave të njeriut dhe të ligjeve humanitare në territorin e ish-Jugosllavisë. Kështu, kompetencat e saj përfshijnë shkeljet e rënda të konventave të Gjenevës të vitit 1949 për mbrojtjen e viktimave gjatë konflikteve të armatosura, krimet kundër njerëzimit, siç janë vrasja, trotura, dhunimi dhe aktet tjera çnjerëzore, të kryera gjatë konfliktit të armatosur, si dhe krimet e gjenocidit. Kjo gjykatë e ndan prokurorin e njëjtë me **Tribunalin Ndërkombëtar Penal për Ruandën (ICTR)** në Arusha, e cila është themeluar pas gjenocidit të vitit 1994. Ndërsa, për **Sierra Leonen** dhe **Kambozhën** janë themeluar Gjykata speciale.

Sikurse në rastin e ICTY dhe të ICTR, jurisdikcioni i ICC paraqet **plotësim të jurisdikcionit vendor**. Vetëm atëherë kur shteti nuk dëshiron ose nuk është në gjendje të ndjekë kryesit e krimeve, ICC merr jurisdikcionin mbi ato raste. Të gjitha këto gjykata bazohen në parimin e përgjegjësisë individuale, pa marrë parasysh pozitën zyrtare të të akuzuarit.

**Gjykata Speciale për Sierra Leonen**, si gjykatë gjysmëndërkombëtare do të hetojë rastet e vrasjeve, dhunimeve, skllavërisë seksuale, shfarsosjes, veprave të terrorit, robërimit, vjedhjeve dhe djegieve. Qëllimi i kësaj gjykate është t’i ndëshkojë vetëm ata individë që kanë përgjegjësi më të mëdha për vuajtjet e popullit të Sierra Leones. Në këtë mënyrë pretendohet që, përmes mekanizmave ligjore, të promovohet pajtimi kombëtar dhe në këtë mënyrë t’i kontribuohet paqes së vazhdueshme.

## **K. INICIATIVAT E TË DREJTAVE TË NJERIUT NË QYTETE**

Programet për forcimin e të drejtave të njeriut në nivel komunal, paraqesin një qasje të re për përdorimin e kornizës së të drejtave të njeriut si udhëzues për zhvillim ekonomik dhe

shoqëror. Në bazë të iniciativës së PDHRE-së, **Lëvizjes Popullore për Arsimim në të Drejtat e Njeriut** – duke përdorur arsimimin për të drejta të njeriut si strategji të zhvillimit shoqëror – disa qytete, siç janë Rosario (Argjentinë), Thies (Senegal), Nagpur (Indi), Kati (Mali), Dinapur (Bangladesh), popujt autoktonë të Arbasit (Filipine) dhe qyteti i Gracit (Austri), kanë shpallur veten “*qytete të të drejtave të njeriut*” ose “*bashki të të drejtave të njeriut*”.

Një tjetër iniciativë është ndërmarrë nga qyteti i Barcelonës, ku në bashkëpunim me qytetin e San Denisit (Saint Denis) në vitin 1998, kanë hartuar “*Kartën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në Qytete*”, e cila deri në vitin 2003, është nënshkruar nga më shumë se 300 qytete, kryesisht të Evropës Mesdhetare. Karta përmban detyrime politike të bazuara në të drejtat ndërkombëtare të njeriut, për të drejtat e migrantëve dhe për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, rekomandon themelimin e institucioneve dhe procedurave lokale, siç janë ombudspersoni, këshillat për të drejta të njeriut ose bilance për vlerësimin e të drejtave të njeriut. Gjatë takimeve të tyre të rregullta, qytetet dhe bashkitë shkëmbejnë mes vete përvojat nga praktikatat e mira.

Përparësia e strategjisë së promovimit të të drejtave të njeriut ndërmjet komuniteteve në nivel komunal, qëndron në faktin se në këtë rast, të drejtat e njeriut mund të adresohen gjatë përditshmërisë. **Metoda** e sugjeruar nga PDHRE dhe me sukses e aplikuar në praktikë, paraqet fillimin e zhvillimit të një plani të përbashkët dhe identifikimit të gjendjes së realizimit dhe shkeljeve të drejtave të njeriut në qytete, e cila do të shpjerë drejt hartimit të një strategjie, që do të shndërrohet në program për veprim. Në këtë proces, qytetarët i shqyrtojnë ligjet dhe politikatat mbi përdorimin e burimeve të qytetit të tyre. Në mënyrë që qytetarët të tejkalojnë problemet lidhur me të drejtat e njeriut nëpër qytete të tyre, zhvillojnë plane për përforsimin dhe realizimin e të drejtave të njeriut. Së bashku me autoritetet, ata përbetohen që të gjitha vendimet, politikatat dhe strategjitë do të bazohen në të drejtat e njeriut.

Për këtë qëllim, është zhvilluar një qasje e përgjithshme ndaj të drejtave të njeriut, që nënkupton se të gjitha të drejtat civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore, duke përfshirë edhe perspektivën gjinore, janë adresuar si një tërësi. Me qëllim që populli të

vetëdijësohet për të drejtat e tyre, ligjërimet, mësimet dhe aktivitetet trajnuese, duke përfshirë këtu edhe programin “*trajnimi i trajnerëve*” për mësues, administratorë, policë, punëtorë shëndetësor dhe social, udhëheqës të shoqatave bashkiake dhe OJQ-ve, janë të një rëndësie primare. Mbikëqyrjen e procesit për një periudhë kohore afatgjatë, e bëjnë sistemet monitoruese, si për shembull Komitetit Drejtues, i cili përfshin të gjithë sektorët e shoqërisë.

Ndërkaq, në nivel ndërkombëtar, është në formim e sipër një asociacion i qyteteve të të drejtave të njeriut, i cili do bëjë mbikëqyrjen e vetëkontrollit të domodoshëm dhe seriozitetit të përpjekjeve të anëtarëve të tij.



### **SHEMBULLI I NAGUPRIT, QYTET I TË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË INDI**

Faza 1 (janar – qershor 1999): Identifikimi i problemeve dhe bartësve kryesorë.

Faza 2 (korrik 1999 – qershor 2000): Konsolidimi i aktiviteteve me ndihmën e grupeve punuese.

Faza 3 (korrik 2000 – dhjetor 2002): Ndërtimi i kapaciteve dhe aktiviteteve trajnuese; mobilizimi i bashkësive në lagje etj.



### **SHEMBULLI I KATIT, QYTET I TË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË MALI**

Prill 2000: Fillimi i procesit

Shkurt 2001: Asambleja e Përgjithshme e Pjesëmarrësve Strategjikë: themelimi i Komitetit. për Orientim dhe Koordinim, si dhe i zyrës për operacionalizim.

Dhjetor 2001: Këshilli i Personave Eminent për Këshillim.

2002/2003: Zhvillimi i Planprogramit dhe Seminaret Trajnuese për Arsimim mbi të Drejtat e Njeriut.



### **SHEMBULLI I GRACIT, QYTET I TË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË AUSTRI**

Shtator 2001: Vendimi unanim i Këshillit të Qytetit të Gracit.

Maj 2001: Ceremonia formale e inagurimit në Universitetin e Gracit, në prezencën e znj. Shulamith Koeing.

Qershor 2002: Prezentimi i planit dhe draftprogramit për veprim, të hartuar në Kuvendin Komunal të Gracit, me ndihmën e më shumë se 100 individëve dhe organizatave.


Tetor 2003: Konferenca për rezultatet e fazës së parë të implementimit.

Ky proces koordinohet nga *Qendra Evropiane e Trajnimeve dhe Hulumtimeve për të Drejtat e Njeriut dhe Demokraci (ETC)* në Grac, e cila gjithashtu ofron programe të ndryshme për arsimim në fushë të të drejtave të njeriut.

## **L. SFIDAT DHE MUNDËSITË GLOBALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT**

Pas disa dekadave të suksesshme në përcaktimin e standardeve, tani si sfidë kryesore e të drejtave të njeriut, është bërë **implementimi** i detyrimeve të ndërmarra. Janë zhvilluar disa metoda për përforcimin e implementimit të të drejtave të njeriut, si në nivel lokal dhe kombëtar, ashtu edhe në nivel ndërkombëtar. Në mesin e tyre parashihet edhe një qëndrim më aktiv i komunitetit ndërkombëtar përmes caktimit të zyrtarëve për të drejtat e njeriut në misione ndërkombëtare dhe institucionalizimit të çështjes së të drejtave të njeriut në terren, që parashihet të ketë efekt të rëndësishëm parandalues.

Respekti për të drejtat e njeriut në nivel lokal dhe kombëtar, gjithashtu është forcuar përmes **ndërtimit të kapaciteteve** të institucioneve vendore për të drejtat e njeriut, siç janë qytetet e të drejtave të njeriut dhe themelimi i institucioneve kombëtare për promovimin dhe monitorimin e të drejtave të njeriut, ku organizatat joqeveritare si përfaqësuese të shoqërisë civile e luajnë rolin kryesor. Ashtu siç shihet edhe nga protokoli shtesë për të drejtat e fëmijës, çështjet lidhur me bioteknologjinë, inxhinierinë gjenetike dhe tregtinë me organe njerëzore, nevojat për **përcaktimin e standardeve** në fushat e reja është ende e pranishme.

Ashtu sikurse në qasjen e ILO-së, të drejtat ekzistuese të njeriut, në të njëjtën kohë mund të bëhen edhe më të dukshme përmes fokusimit në “*të drejtat kryesore*”. Sfidat e reja mund të shihen edhe nga ekzistimi i nevojës për kushtim të vëmendjes marrëdhëniesve mes të drejtave të njeriut dhe të drejtës humanitare, siç janë “*standardet fundamentale të njerëzimit*”.  Moduli për të Drejtat e Njeriut në Konfliktet e Armatosura. E njëjta

gjë vlen edhe për marrëdhënien mes **të drejtave të njeriut dhe të drejtës së refugjatëve**, që ekziston si në shkallën e parandalimit të problemeve të refugjatëve, ashtu edhe në atë të kthimit të tyre. Në të dyja këto raste, vendimtare është gjendja e të drejtave të njeriut në vendin e origjinës. Me qëllim të trajtimit të personave të zhvendosur brenda territorit të tyre, janë zhvilluar parimet udhëzuese. Kjo ngre një problem më të gjerë si ai i **të drejtave të njeriut dhe parandalimit të konflikteve**, ashtu edhe çështjen e **rehabilitimit dhe rindërtimit pas përfundimit të luftës**, të cilat duhet të ndërmerren duke u bazuar në të drejtat e njeriut dhe në sundimin e ligjit.

**Përgjegjësia** për respektimin dhe shkeljen e të drejtave të njeriut është bërë një brengosje globale, e cila kërkohet jo vetëm nga individët, por gjithashtu nga edhe nga institucionet joshtetërore, kompanitë transnacionale (TNCs) dhe organizatat ndërqeveritare siç janë, Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar (IMF) dhe Organizata Ndërkombëtare e Tregëtisë (WTO).

Në rastin e kompanive transnacionale, në bazë të propozimit të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara Kofi Anan, në vitin 2000 është lansuar **Marrëveshja Globale**, si një qasje e re dhe inovative në procesin e globalizimit. Kompanitë pjesëmarrëse i pranojnë 9 parimet kryesore nga fusha e të drejtave të njeriut, standardeve të punës dhe mjedisit si dhe angazhohen në bisedimet e orientuara në problemet globale siç është roli i biznesit në zonat e konfliktit.

Një sfidë e re ndaj sigurisë njerezore dhe të drejtave të njeriut ka rezultuar pas sulmeve të 11 Shtatorit, kur shtetet kanë përforcuar masat antiterroriste, që pjesërisht kanë rezultuar në kufizimin e të drejtave themelore të njeriut.

*Dispozitat ndërkombtare të pranuar gjërësisht – si liria nga arrestimi arbitrar ose burgimi i paafatizuar, e drejta në proces të drejtë gjyqësor, e drejta në panel të pavarur, gjykim të paanshëm, gjyqtar të pavarur, përfaqësim ligjor ose liria nga trajtimi çnjerëzor dhe poshtëruar – janë dispozita që sot ndodhen nën rrethim. Ne duhet të tërheqim një vijë dhe t'i mbrojmë ato. Kjo paraqet, gjithashtu, një pyetje të madhe të sigurisë. Kur siguria definohet shumë ngusht – për shembull, si asgjë më shumë se detyrimi i shtetit për t'i*

*mbrojtur shtetasit e vet – atëherë nevoja për siguri mund të shkaktojë shkeljen e të drejtave të atyre që kanë mbetur jashtë rrethit të të mbrojturve.*

**SERGIO VIERIA DE MELLO, KOMESAR I LARTË I OKB-së PËR TË DREJTAT E NJERIUT, 2003**

## **M. BIBLIOGRAFIA**

**Alfredson, Gundumur et. Al. 1999.** *The Universal Declaration of Human Rights.* Oslo: Scandinavian University Press.

**Alston, Philip and James Crawford (eds.). 2000.** *The Future of UN Human Rights Treaty Monitoring.* Cambridge: Cambridge University Press.

**Alston, Philip (ed.). 1999.** *The EU and Human Rights.* Oxford: Oxford University Press.

**Andreopoulos, George J. and Richard Pierre Claude. 1997.** *Human Rights Education for Twenty-First Century.* Philadelphia: University of Pennsylvania Press.

**An-Na'im, Abdullahi Ahmed (ed.). 1992.** *Human Rights Cross-cultural Perspectives, A Quest for Consensus.* Philadelphia: University of Pennsylvania Press.

**Asia-Europe Foundation (ASEF). 2000.** *The Third Informal ASEM Seminar on Human Rights. Singapore.*

**Bankie, B.F., Marias and J. T. Namiseb (comp.). 1998.** *Towards Creating a Sustainable Culture of Human Rights: the Southern African human rights reader.* Windhoek: Macmillan.

**Baefsky, Anne F. 2002.** *How to Complain to the UN Human Rights Treaty System.* Transnational Publishers.

**Baxi, Upendra. 1994.** *Inhuman Wrong and Human Rights: Unconventional Essays.* Delhi: Har-Anand Publications.

**Baxi, Upendra. 2002.** *The Future of Human Rights.* Oxford University Press.

**Benedek, Wolfgang (ed.). 1999.** *Human Rights in Bosnia and Herzegovina, Theory and Practice.* The Hague: Martinus Nijhoff Publishers.

**Benedek, Wolfgang, Esther M. Kissaakye and Gerd Oberleitner (eds.). 2002.** *The Human Rights of Women: International Instruments and African experiences.* London: Zed Books.

**Benedek, Wolfgang and Alice Yotopoulos-Marangopoulos (eds.). 2003.** *Anti-Terrorist Measures and Human Rights,* Kulwer Law International (upcoming).

**Bjekovic, Sinisa, Vedrana Spahic-Vrkas and Nebojsa Vucinic (eds.). 2003.** *Human Rights for Non-Lawyers.* Sarajevo: DD Stamparija Svjetlost – Fonica.

**Buergenthal, Thomas, Diana Shelton and David Stewart. 2002.** *International Human Rights in a Nutshell.* St. Paul: West Group.

**Buergenthal, Thomas, Diana Shelton. 1995.** *Protecting Human Rights in the Americas – Cases and Materials.* 4th rev. ed., Kehl: Engel.

**Caney, Simon and Peter Jones (eds.). 2001.** *Human Rights and Global Diversity.* London: Frank Cass Publishers.

**Cassese, Antonio. 2001.** *International Criminal Law. A Commentary on the Rome Statute for an International Criminal Court.* Oxford: Oxford University Press.

**Council of Europe (ed.). 2000 (2nd ed.).** *Human Rights in International Law, Basic texts.* Strasbourg: Council of Europe Publishing.

**Council of the European Union. 2002.** *Annual Report on Human Rights.* Brussels: European Communities.

**Davidson, Scott. J. 1997.** *The Inter-American Human Rights System.* Aldershot: Ashgate Publishing Company.

**de Mello, Sergio Vieira. 2003.** Statement to the Opening of the Fifty-Ninth Session of the Commission on Human Rights of 17 March 2003; Report of the UN High Commissioner for Human Rights and Follow-Up to the World Conference on Human Rights, UN Doc. E/CN.4/2003/14 of 26 February 2003.

**Donnelly, Jack. 2003 (2nd ed.).** *Universal Human rights in Theory and Practice*. Ithaca etc. Cornell University Press.

**Dunne, Tim. and Nicholas J. Wheeler (eds.). 1999.** *Human Rights in Global Politics*. Cambridge: Cambridge University Press.

**Evans, D. Malcolm and Rachel Murray. 2002.** *The African Charter on Human and Peoples' Rights. The System in Practice, 1986-2000*. Cambridge: Cambridge University Press.

**Forsythe, David P. 2000.** *Human Rights in International Relations*. Cambridge: Cambridge University Press.

**Freeman, Michael. 2002.** *Human Rights*. Oxford: Polity

**Galtung, Johan. 1994.** *Human Rights in Another Key*. Polity Press.

**Garcia, Ramirez. 2001.** *El Futuro del Sistema Inter-Americano de Proteccion de los Derechos Humanos*, in: Garcia Ramirez, S., (ed.), *La jurisprudencia de la Corte Interamericana de Derechos Humanos*. Mexico, 1118-1144.

**Ghai, Yash. 1999.** *Human Rights, Social Justice and Globalisation*, in: Bell, D. And Bauer, J. (eds.), *The East Asian Challenge to Human Rights*. Cambridge: Cambridge University Press.

**Ghai, Yash. 1998.** *Human Rights and Asian Values'*. *Public Law Review*, Vol. 9/3, 168-182.

**Goldewijk, Berma K., Adalid C. Baspineiro and Paulo C. Carbonari (eds.). 2002.** *Dignity and Human Rights. The Implementation of Economic, Social and Cultural Rights.* Antwerp: Intersntia.

**Gomien, Donna. 1998.** *Short Guide to the European Convention on Human Rights.* Strasbourg: Council of Europe (2nd ed.)

**Gomien, Donna, David Harris and Leo Zwaak. 1996.** *Law and practice of the European Convention on Human Rights and the European Social Charter.* Strasbourg: Council of Europe.

**Hanski, Raija and Markku Suksi (eds.). 1999.** *An Introduction to the International Protection of Human Rights.* A Textbook, Turko/Abo: Institute for Human Rights . Abo Akademi University (2nd ed.)

**Ishay, Micheline R. (ed.). 1997.** *The Human Rights Reader: Major Political Writings, Essays, Speeches and Documents from the Bible to the Present.* London, Routledge.

**Jones, John R.W.D. 2000.** *The Practice of the International Criminal Tribunals for the Former Yugoslavia and Rwanda.* Irvington-on-Hudson. NY: Transnational Publishers (2nd ed.)

**Maddex, Robert, L., 2000.** *Intenrational Encyclopedia of Human Rights.* Washington: Congressional Quarterly Press.

**McRae, Rob and Don Hubert (eds.). 2001.** *Human Security and the New Diplomacy, Protecting People, Promoting Peace.* Montreal: McGill-Queen's Univeristy Press.

**Mernissi, Fatima. 1995.** *Arab Women's Rights ans the Muslim State in the Twenty-first Century: Reflections on Islam as Religion and State. Faith and Freedom: Women's Human Rights in the Muslim World.* London, I.B. Tauris & Co.

**Newman, Edward and Oliver P. Richmond (eds.). 2001.** *The United Nations and Human Security.* New York: Palgrave.

**Nowak, Manfred. 1999.** *Human Rights “Conditionality” in Relation to, and Full Participation in, the EU*, in: Alston, Ph. (ed.), *The EU and Human Rights*. Oxford: Oxford University Press, 687ff.

**Nowak, Manfred, 2003.** *International Human Rights Regime*. Kulwer Law International.

**Office of the High Commissioner for Human Rights et al. 1997.** *Manual on Human Rights Reporting*. Office of the High Commissioner for Human Rights.

**Office of the High Commissioner for Human Rights. 1998 (3rd ed.).** *Basic Human Rights Instruments*. Geneva: United Nations Publication.

**OSCE. 2000.** *OSCE Handbook*. Vienna.

**Ramcharan, Bertrand G. 2002.** *Human Rights and Human Security*. The Hague etc.: Martinus Nijhoff Publishers.

**Robertson, Geoffrey. 2002.** *Crimes Against Humanity. The Struggle for Global Justice*. London: Penguin.

**Sen, Amartya K. 1999.** *Culture and Human Rights. Development as Freedom*. Oxford: Oxford University Press.

**Sicilanos, Linos-Alexander and Christiane Bourloyannis-Vrailas (eds.). 2001.** *The Prevention of Human Rights Violations*. The Hague: Martinus Nijhoff Publishers.

**Smith, Rhona. 2003.** *Textbook on International Human Rights*. Oxford: Oxford University Press.

**Steiner, Henry J. and Philip Alston. 2000 (2nd ed.).** *International Human Rights in Context, Law, Politics, Morals, Text and Materials*. New York: Oxford University Press.

**Symoniders, Janusz and Vladmit Volodin (eds.). 2001.** *A Guide to Human Rights, Institutions, Standards, Procedures*. Paris: UNESCO.

**Symoniders, Janusz and Vladmit Volodin. 1999 (2nd ed.).** *UNESCO and Human Rights, Standard-Setting Instruments, Major Meetings, Publications, Selection of documents and introduction.* Paris: UNESCO.

**Symoniders, Janusz (ed.). 2000.** *Human Rights: Concept and Standards.* Ashgate: UNESCO.

**Todorovic, Mirjna (ed.). 2003.** *Culture of Human Right,* Belgrade Human Rights Centre.

**Umzurike, U. Oji. 1997.** *The African Charter on Human and People's Rights.* The Hague: Martinus Nijhoff Publishers.

**Weston, Burt H. And Stephen P. Marks. 1999.** *The Future of International Human Rights.* New York: Transnational.

**Willets, Peter (ed.). 1996.** *The Conscience of the World, The Influence of Non-Governmental Organizations in the UN System.* London: Hurst.

**Wilson, Richard A. 1997.** *Human Rights, Culture and Context, Anthropological Perspectives.* London: Pluto Press.